

DONATO CARRISI
SHTËPIA E DRITAVE
ROMAN

BOTIMET TOENA

DONATO CARRISI

SHTËPIA E DRITAVE

Përktheu nga origjinali italisht: Xhimi Lazri

Trilogjia Pietro Gerber
Volumi III

BOTIMET TOENA
TIRANË

Autori: Donato Carrisi (Donato Karizi)

Titulli në origjinal: La casa delle luci

Botoi në italisht: Longanesi & C., Milano, 2022

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe Kopertina: Elsa Haderaj

ISBN

© Donato Carrisi, 2022

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi në asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha" nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

SHTËPIA E DRITAVE

*Nënës sime,
që duke më rrëfyer histori,
më mësoi të rrëfeja dhe unë.*

Rregullat e lojës së njerëzve të dyllosur, ose lojës me dyllë ose lojës “ishe dhe nuk je më”.

1. Njeriu i dyllosur ndjek të gjallët
2. Ai që preket kthehet në njeri të dyllosur dhe ndjek të gjallët.
3. Njerëzit e dyllosur e kanë të ndaluar të flasin. Munden vetëm të fërshëllejnë.
4. Loja përfundon kur i gjalli i fundit thotë fjalën “Arimo”.
5. Kur i gjalli i fundit nuk thotë “Arimo”, loja nuk mbaron më kurrë.

ARIMO

Pjetër Xherberi vdiq të hënën e parë të korrikut rreth orës dhjetë e tridhjetë në një mëngjes të nxehtë vere.

E megjithatë, ajo ngjarje do të përbënte vetëm një episod të caktuar në tërësinë e ndodhive të jetës së tij. Me kalimin e kohës rëndësia e saj do të ishte aq sa e gjithçkaje tjetër që ka zënë vend në katalogun e kujtesës. Për hir të së vërtetës duhet thënë se mund të quhej e gabuar ta cilësoje edhe si “kujtim”, pasi Pjetri Xherberi nga ai çast do të mbante mend shumë pak.

Më së shumti kujtonte vetëm detajet që i kishin paraprirë ngjarjes fatale.

Dhoma ngjyrë jargavani në katin e parë të vilës në *Porto Ercole*. Aroma e livandës. Shtrati i rregulluar. Dritarja që binte mbi kopsht e hapur tej e tej, perdet prej dantelle që valëzonin si fantazma drejt qiellit të kaltër. Ai farë gulçimi i çliruar nga atletet e konsumuara, kur fërkoreshin me pllakat prej terakote ndërkohë që rende të fshihej në ballkon, i ndjekur nga një hordhi bashkëmoshatarësh të vendosur ta kapnin në mënyrë që të përfundonte loja.

Djersa që i rridhte nga flokët te faqet e nxehtura teksa kalonte përmes dhomës. Shija e njelmët e piklave që i përfundonin në gojë. Dihatja dhe buzëqeshja e pavetëdijshme

që i ndriçonte fytyrën në çastin kur kthehej një moment që të kontrollonte ata që i ishin qepur këmba këmbës.

Pantallonat e shkurtra, bluza *Pikaçu* e zbërdhulur. Koriça te gjunjët nga të rrëzuarit e panumërt me biçikletë. Lëkura e nxirë nga dielli. Aroma e rozmarinës që fshihej në ajrin e verës.

Moskokëçarja e tij prej fëmije njëmbëdhjetë vjeç tre muaj, gjashtëmbëdhjetë ditë, dhjetë orë, njëzet e nëntë minuta dhe ca pak sekonda.

Krahët e shtrirë drejt parmakut prej hekuri, i cili sipas parashikimeve të tij, do të ketë detyrën t'ia frenojë atë vrap të marrë. Kangjellat që duket sikur e kryejnë siç duhet atë detyrë, sapo Pjetri mbështetet me gjithë trupin, por që më pas valëzon papritur sikur të ishte prej gome. Dhe, në mënyrë të pakuptimtë, duke iu rebeluar palëvizshmërisë, së cilës i qenë nënshtruar prej dhjetëra vitesh, ato shkëputen nga muri i shtëpisë së vjetër, duke nisur një udhëtim drejt së panjohurës, sikur t'u dukej se mund të hidhnin poshtë forcën e rëndesës, madje edhe të fluturonin

Relikti metalik, i cili e zvarrit me tërë peshën në hon, teksa ai vazhdon të mbahet ende aty. Buzëqeshja e një fëmijë që shuhet në fytyrë, teksa zhyten së bashku në zbrazëti. Sytë që mbushen me tmerr kur shohin si afrohet me shpejtësi zalli i bardhë i kopshtit. Përplasja që pritet nga një shpërthim aq zhurmshëm, por që në të vërtetë është vetëm tringëllimi i zymtë dhe i qartë i diçkaje që thyhet e që i paraprin territ.

E megjithatë, duke u kthyer pas në kohë, ajo ditë vere e vitit 1997 kishte nisur në mënyrën më të mirë për Pjetrin e vogël. Mauricio, kushëriri i tij kishte shkuar te vila e tyre në

bregdet për të kaluar verën me Pjetrin, të atin e këtij dhe me Adelën, guvernanten e shtëpisë. Pjetri kishte mbetur jetim nga nëna pa mbushur as dy vjeç dhe i ati nuk u martua më. Ishte fëmijë i vetëm, prandaj Mauricio, të cilin në familje prej ngaherë e kishin thërritur Isho, mund të quhej gati si një vëlla, ndonëse ishin moshatarë.

Atë vit, pak kohë pasi kishte mbaruar shkolla, Mauricion e dërguan të kalonte gjithë verën të kushërinjtë e të atit në Porto Erkole. Me ta mësuar këtë lajm nga i ati, Pjetrin nuk e mbante vendi. Dy muaj të tërë, nga korriku në shtator me Ishon. E pabesueshme! Do të ishte vërtet kryevepër ta fusnin edhe atë te banda e tyre.

Në atë grumbulli shtëpish verimi ndërtuar rrëzë brinjës së gjirit, me pamje nga qyteti dhe nga deti, ndër kohëra krijoheshin çdo vit banda fëmijësh. Kalimi i traditës nga një brez në tjetrin ndodhte pak a shumë në kapërcyell të adoleshencës, ku zakonisht humbet interesi për disa aktivitete të lidhura me fëmijërinë. Më të mëdhenjtë parapëlqenin ta kalonin kohën në plazh apo duke u mbledhur te një shesh i vogël me pretekstin e ndonjë akullloreje në bar “Roma” apo mbrëmjeve te kafene King përpara se të shkonin te kërcenin te një lokal që quhej “Le Strega”.

Ishoja u bë pjesë e bandës së vogël të bashkëmoshatarëve, e cila në filli të viteve Nëntëdhjetë, kishte marrë kontrollin e zonës në periudhën e pushimeve. Përveç Pjetrit dhe kushërirrit, numëroheshin edhe gjashtë anëtarë të tjerë nga zona të ndryshme të Toskanës.

Të gjithë ishin njëmbëdhjetëvjeçarë, ndaj ogurin e keq se ajo e 1997-ës, me gjasa do të ishte një ndër verat e fundit, në mos e fundit e fëmijërisë, e ndienin të gjithë. Për këtë arsye,

qysh në krye të herë, ata sikur kishin bërë be që ta jetonin në kulm, duke i shijuar të gjitha mundësitë që u jepte statusi prej fëmije, duke marrë disa liri, të cilit nuk do t'i gëzonin më kurrë.

Në shtator, përpara se të ktheheshin secili në qytetin e vet, do të përshëndeteshin dhe si ngaherë do të linin takim për korrikun e vitit të ardhshëm. Por kur të vinin në Porto Erkole, në vend të shokëve të vjetër të kohës, do të gjenin të tjerë. Miqësia, sigurisht do t'i bënte ballë provave të kohës, megjithatë edhe vetëm mendimi që t'u jepeshin disa gjërave të caktuara i bënte të skuqeshin nga turpi.

Por hë për hë, mund të mos e vrisnin mendjen dhe të bënë qejf si budallenj për sa kohë e kishin të mundur.

Në grup bënte pjesë Debora nga Siena, e vetmja vajza, ndonëse djemtë nuk i vinin shumë rëndësi përkatësisë së gjinisë. Kjo do të ndodhte një verë më pas, kur kjo Debora, tashmë e lulëzuar, do t'i vinte në siklet duke u zbuluar atyre impulse të paplanifikuara

Etoje vinte nga Fiezolet dhe kishte zakon të lëshohej me biçikletë në tatëpjeta të forta e duke frenuar vetëm në çastin e fundit me këmbë.

Karletto ishte frekuentuesi më pak i zellshëm i shoqërisë pasi e ëma e detyronte të merrej orë të tëra me mësim edhe gjatë pushimeve. Pjesën tjetër të vitit jetonte në Groseto, mbante syze dhe gjente gjithmonë mënyrën si të vritej e të bëhej copë.

Xhovani nga Empoli, gjithë kohës i uritur quhej “Xhovanone” sepse duke qenë i bëshëm i vinin masat e vëllait gjashtëmbëdhjetë veç. Ky ishte i famshëm për të bërë hedhje “bombë” në ujë nga lart.

Dante vinte nga Luka dhe kishe maninë të shkatërronte gjërat. Thoshte se donte të shihte si ishin nga brenda.

Mandej ishte Pjetër Xanusi, të cilin për shkak të homonimisë me Pjetër Xherberin, të gjithë e thërrisnin me emër e mbiemër. Ishte trembëdhjetë vjeç dhe veterani i grupit. Për shkak të një metamorfoze të rrëmbyer hormonale, qysh prej viti të shkuar, ky po shkëputej pak e nga pak nga banda dhe po afrohej me djem e vajza më të mëdha në moshë. Në verën e 1997 vendin e tij e zuri i vëllai, ndonëse sapo kishte mbushur pesë vjeç.

Xeno Xanusi kishte hyrë në grup, jo për ndonjë të drejtë të trashëguara apo ngaqë tregonte se ishte shumë më i pjekur për moshën e tij, por ngaqë këtë e kishte vendosur Debora, e cila e trajtonte si të mbrojturin e saj.

Xeno ishte tifoz i çmendur i Fiorentinës. Bluzën me numrin 9 të idhullit të tij Gabriel Batistutës s’e hiqte as natën, përveç rasteve kur detyronte e ëma. Prej kësaj i kishin vënë edhe llagapin “Batigol”.

Gjatë pushimeve në Arxhentario, fëmijëve u ndodhte diçka e mbinatyrshe: harronin televizorin, videolojërat dhe të gjitha mënyrat si e kalonin kohën në qytet. Si për çudi, jepeshin pas tërë dëfrimeve, njëllonj si prindërit tyre kur kishin qenë në të njëjtën moshë.

Pjetri, Isho dhe grupi i vogël i miqve të Porto Ercoles nga agimi deri në perëndim i kalonin orët duke u hedhur në det tek Triangolo, duke zbritur me biçikleta nëpër shtigje me dhe’, duke u lagur me ujë, duke kapur gaforre e me ndeshje futbolli pa mbarim në plazh nën diellin përvëlues.

Por kishin edhe një lojë, e cila nuk përfshihej kurrë mes atyre le të themi “zyrtare”, ndonëse e luanin më shpesh.

Loja shërbente për të mbushur “dritaret” nga një kohë te tjetra, në pritje që ndokujt t’i vinte në mendje ndonjë dëfrim i ri, për të cilin të binin të gjithë në një mendje. Qëllimi i padeklaruar i asaj loje ishte që mërzia të mos lejohej të fuste këmbët gjatë atyre intervaleve të vdekura. Mërzia është armikja kryesore për fëmijët gjatë verës. Ajo zë pusi, në pritje që ndonjë re të errësojë qiellin qoftë edhe për një çast të vetëm apo që ndonjë gozhdë e ndryshkur që të futet në kopertonin e biçikletës a të ndonjë topi të shkëlmuar me shumë vrull e të grabitur nga dallgët.

Fëmijët e Porto Ercoles, në të gjitha kohërat e dinin se metoda më efikase për ta mbajtur mërzinë larg ishte loja e njerëzve të dyllosur apo shkurt loja e dyllit, që në disa raste kthehej në *loja e ishe (dhe nuk je më)*.

Ky ishte varianti toskan i një loje të përhapur në çdo cep të globit, me elementë të ngjashëm me “ngriva-shkriva” dhe “kukafshehtas”. Dikush caktohej si njeriu i parë i dyllosur, i cili kishte për detyrë të gjente të tjerët - “të gjallët” - për t’i shndërruar në njerëz të dyllosur, thjesht duke i prekur. Të pafatët që nuk arrinin t’i shpëtonin fatit të kobshëm, që nga ai çast mund të ndihmonin në zbulimin e të tjerëve. Gjithçka kryhej pa folur dha pa pasur mundësi këmbimi informacionesh në lidhje me vendet ku ishin fshehur ata që duheshin kapur.

Në fakt, komunikuar mes “të dyllosurve” mund të kryhej vetëm me fishkëllima

Kush shkelte rregullin, brenda tri ditësh do të vdiste nga një vdekje e dhunshme. Dhe, ndonëse asnjëri nga fëmijët nuk e besonte vërtet, të gjithë ruheshin në kulm, se mos e shkëlnin këtë normë.

Mes fëmijëve të Porto Ercoles, rrëfehej ende legjenda e një djali nga Pisa, i cili duke mos mundur të përfundonte lojën pasi ishte dita e fundit e pushimeve, u kthye në qytet bashkë me mallkimin mbi vete. Prej asaj dite, në mënyrë që të mos vdiste nga vdekja mizore, shprehej vetëm me fërshëllima. Teorikisht, fitimtari i lojës ishte i vetmi i mbijetuar. Por nuk mjaftonte vetëm që ky të kapej nga të tjerët. E rëndësishme ishte që të shqiptonte një fjalë të caktuar për të çliruar të dyllosurit nga detyrimi i heshtjes.

Arimo.

Kjo ishte fjala e mistershme, nga ku rridhte një pushtet gjigand, përmes të cilit dërmoje kundërshtarët dhe talleshe me ta.

Askush nuk e dinte nga vinte ajo fjalë dhe as çfarë kuptimi kishte realisht. Ndoshta, me kalimin e kohës duke kaluar gojë me gojë, koncepti ishte shndërruar deri sa kishte humbur shqiptimin e saktë dhe kuptimin fillest r. Por fëmijëve nuk u interesonte çfarë donte të thoshte fjala. U mjaftonte të dinin se shqiptimi i saj u jepte fund armiqësive. Dhe, nëse i mbijetuari i fundit, refuzonte të thoshte “Arimo”, shokët e bllokonin dhe nisin ta gudulisnin deri sa të dorëzohej.

Siç ndodhte shpesh, edhe atë të hënë të parë të korrikut, dita e vdekjes së Pjetrit, lojën e dyllosjes nuk propozoi askush. Ndonjëherë nuk ishte as e nevojshme. Mjaftonte që dikush të prekte një tjetër dhe ndjekja fillonte në vend. Ndoshta, atë ditë, i pari e kishte filluar Ishoja. Sfida kishte nisur te sheshi përpara vilës së familjes Xherber që zgjatej kah majës së pyllëzuar shkëmbore mbi det.

Pjetri ishte i gëzuar që më në fund kushëriri kishte shkuar te ta në shtëpinë e plazhit. Sipas xhaxhait dhe nuses së tij, i kushëriri ndihej pak i trishtuar ngaqë atë pranverë i kishte vdekur Saturni, qenushi i racës Barbonçino.

Kësisoj, Pjetri, kishte për detyrë ta bënte të harronte Saturnin.

Gjatë javëve në vijim, do të bënë gjithë ato gjëra bashkë. Disa zakone verore përsëriteshin qysh kur kishin qenë të vegjël. Këtu futej leximi i revistave vizatimore natën vonë poshtë çarçafëve apo kapja e merimangat nga tavani dhe fshehja e tyre te sirtarët e Adelas së gjorë. Atë mëngjes, babai i Pjetrit u kishte premtuar një ekskursion me varkë në Ishullin *Xhilio* e ku do ta merrni ushqimin me vete: bukë, sallam dhe kokakola të ngrirë në shishe.

Për të shtyrë kohën në pritje të nisjes, ai dhe Ishoja u takuan me shokët e tjerë që kishin ardhur të përshëndeteshin me rishtarin.

Në të vërtetë Pjetrit nuk ia kishte shumë ënda të luante me dylllosje. Ndoshta ishte njëlloj parandjenje, ndoshta thjesht dembeli. Por dita ishte aq e kthjellët dhe e nxehtë sa nuk u tërhoq pas.

Në një ditë të tillë, askush nuk e priste vdekjen. Aq më pak një fëmijë.

Sot dua të jem i gjalli i fundit tha me vete, ndërkohë që fëmijët e tjerë gjurmonin njëri-tjetrin. *Dua ta kem unë të drejtën të them “Arimo” dhe t’i detyroj të më ndjekin deri sa t’u djegin mushkëritë dhe t’i zërë ngërçi te këmbët.* Dhe bëri gjithë sa mundi që të mos ta kapnin të dylllosurit, të cilët po shtoheshin gjithnjë e më tepër.

Kopshti i vilës në Porto Ercole ishte i përkryer për atë lojë: gëmushat dhe shkurret u ofronin pjesëmarrësve mundësi të shumta për t'u fshehur. Në të vërtetë, ishte i përkryer vetëm për këtë veprimtari, sepse pikërisht për shkak të bimësisë së dendur, gëzonte edhe famën e tmerrshme se përpinte çdo lloj topi apo zari, pa ia kthyer pronarit të ligjshëm. Aq sa fëmijët që shpesh ktheheshin në shtëpi duarbosh e kishin pagëzuar “Kopshti i shpresës së humbur”.

Sidoqoftë, djaloshi Pjetër atë ditë e ndiente se fitoren e kishte në dorë.

Ishte fshehur në disa vende, por gjithnjë e diktonin dhe gjithnjë detyrohej të fshihej përsëri. Nja dy herë kishte ndier ta fshiknin gishtat e ndonjërit prej shokëve, që në ato çaste të rrufeshme ishin aq të elektrizuar sa ngjanin vërtet si zgjatime të veshtullta prej dylli. Por me gjasa, bëhej fjalë vetëm për një ndjesi, e cila shkactohej prej zhvendosjes së ajrit, pasi asnjëri nuk kishte dalë me pretendimin se e kishte prekur. Në një moment të caktuar, i strukur poshtë një stoli guri te tenda në kopsht, Pjetri kuptoi se kishte mbetur i vetmi i mbijetuar. Në kopshtin e shpresës së humbur kishte rënë një heshtje ogurzezë dhe “të dyllosurit” komunikonin me fërshëllima.

E dinin se kishte mbetur vetëm ai dhe po e kërkonin.

Pjetri, ndërkohë kishte zhvendosur vështrimin për nga shtëpia, duke shquar derë-dritaren e kuzhinës, e cila ishte zhvendosur pak anash. Deri atë ditë askush nuk kishte guxuar të dilte nga perimetri i kopshtit dhe loja e dyllosjes nuk kishte depërtuar në brendësi të vilës. Por ndoshta kishte ardhur çasti që ai rregull i pashkruar të ndryshonte. Mendoi se me siguri asnjërit prej tyre nuk do t'i shkonte mendja.

Dua të më ndjekin deri në katin e dytë. Dua t'i shoh të mblidhen të gjithë pas meje te shkalla e pjerrët, të kapen te parma me gojën hapur dhe sytë t'u dalin si kokërdhokë. Dua që të plandosen nëpër shkallë, të gulçojnë nga lodhja, tha me vete dhe mori vendimin.

Doli nga vendi ku ishte fshehur dhe nisi të bërtiste për të sinjalizuar praninë. Duke gërthitur, rendi për nga shtëpia e madhe. Të ngrirët mbinë nga të katër anët, duke gjëmuar si kafshë të uritura dhe me një xixëllim djallëzor në sy. Në fillim, siç edhe pritej u kapën në befasi. Por më pas, duke rendur në drejtim të tij, formuan një ushtri të rregullt.

U fut me shpejtësi te spiralja e derë-dritares së kuzhinës dhe përpara i doli Adela, e cila, për habi lëshoi një klithmë të shkurtër, por më pas, duke harruar mirësjelljen e shau në një toscançe të rëndë. Pjetri i kërkoi ndjesë, por nuk ndalej dot. Shkallët i kishte m'u përpara. Nisi t'i ngjiste dy e nga dy dhe në krahë kishte atë ndjesinë frikë e gëzim njëkohësisht që e dinë vetëm fëmijët. Vështroi pas për herë të parë dhe skena ishte ashtu siç e kishte menduar, me ndjekësit e qepur këmba këmbës.

Por Ishoja, i cili në atë çast komandonte “të dyllosurit” dukej se nuk kishte asnjë qëllim të hiqte dorë.

Pjetri nuk e kishte menduar se çfarë do të bënte pasi të ngjitej lart. Ideja fillestare parashikonte që armiqët të dorëzoheshin te shkallët. Tani ishte i detyruar të hartonte plan tjetër.

Kështu, rendi për të dritarja e hapur në fund të dhomës, e cila dikur kishte qenë e nënës së tij. Aty Pjetri hynte rrallë. Sado që praktikisht nuk kishte asnjë kujtim prej saj, duke qenë se ajo kishte vdekur përpara se mendja e tij prej fëmijë

të nguliste kujtime kohëgjata, ajo dhomë gjumi përfaqësonte gjithsesi diçka të shenjtë. Aty brenda, për shembull, ishte një komo sipër së cilës ishte ekspozuar një koleksion me parfume grash. Shishka të panumërta, të ngjyrosura e me forma elegante, të vendosura njëra përbri tjetrës, në një rend të pashpjegueshëm. Herë, pas here, Pjetri futej fshehtazi të atit në dhomën ngjyrë jargavani për t'i marrë erë ndonjëres prej atyre esencave. Me kalimin e viteve, shumë prej parfumeve kishin avulluar, kishin humbur aromën, apo në shishkat prej xhami nuk kishte mbetur gjë tjetër veç një lëngu të turbullt tashmë të pavlerë.

Megjithatë, Pjetri ngulmonte të kërkonte një shenjë të dukshme, një aromë të mbetur me shpresën që të ringjallte qoftë edhe ndonjë kujtim të vogël të gruas, që e kishte sjellë në jetë. Tani, duke shkuar drejt ballkonit, në kulm të lojës së “dyllosjes” ndërkohë që po kalonte te komoja pa se dielli kishte hyrë mes shishkave prej kristali, të cilat si një mori prizmesh të vegjël, projektonin rrezet e ngjyrosura në muret aty rrotull.

Pamja e asaj të fshehte hyjnore i dha ndjesinë e një çasti paqeje.

E harroi thuajse përnjëherë pasi për momentin, kishte pikësynim dritaren. Do të zgjatej prej saj dhe do të bërtiste menjëherë me sa i hante fyti “Arimo” për të shmangur kapjen dhe torturën e gudulisjes. Ajo britmë do të tingëllonte çliruese për të dyllosurit e vegjël e po ashtu edhe për të.

Por qëllimet ia asgjësoi kontakti me parmakun prej hekuri. Nuk pati ndjesinë se po rrëzohej. Iu duk sikur bota papritmas nuk po e mbante më dhe të gjitha gjërat materiale

po largoheshin me shpejtësi nga supet e tij, duke e lënë në mëshirën e përqaqimit të zbrazëtisë

Heshtje dhe terr

Kur i hapi sërish sytë, mezi merrte frymë. I bëhej sikur dikush i kishte futur me zor në fyt një grusht dhe' të kalbur. Në breroren e një drite diellore verbuese, pranë vetes dalloi fytyrat e të dyllosurve. Ishin përkulur sipër tij me duart mbështetur te gjunjët. E zhbironin njëlloj si një bretkosë që sapo ka mbetur e shtypur mbi asfalt, por pa pasur guxim të t'i afroheshin më tepër dhe para së gjithash, pa thënë asnjë fjalë. Ajo heshtje e tmerroi.

“Arimo”, tha me një fije zëri, mjaft që t'i dëgjonte të flisnin

Nga buzëqeshjet e tyre të lehtësuara, kuptoi se ishte ende gjallë. Më pas arriti të lëvizte kokën aq sa mjaftonte që të shikonte të atin të ulur në gjunjë pranë tij te guriçkat. I zverdhur dyllë në fytyrë nga frika. Gulçonte sikur të kishte rendur me kilometra të tërë pa ndaluar dhe ishte bërë qull në djersë. Duart i mbante ende të kryqëzuara mbi kraharror dhe vazhdonte të shtypte ritmikisht si piston mbi dërrasën e kraharrorit.

Kur e pa që i biri u përmend, ai u bllokua. Ishte i dërrmuar.

Çfarë kishte ndodhur? Pjetri thuajse nuk e mbante mend rënien. Më pas e kapi një valë dhimbjesh, sikur trupi t'i ishte bërë një mijë copa. Ndjeu aromën metalike të gjakut, ndërsa në kokë i ishte formuar një rreth dhe këmbën e djathtë nuk arrinte ta lëvizte.

Por ajri i nxehtë i verës nisi t'ia mbushte mushkëritë

Sado që të rriturit në familje dhe fqinjët flisnin për incidentin si për një fakt që lidhej me të, Pjetrit gjithnjë i

dukej se ata e kishin fjalën për dikë tjetër. Nuk ishte dot në gjendje të përpunonte në kokë idenë e vdekjes së tij, ndoshta ngaqë ishte ende fëmijë.

Zemra i kishte ndalur për gati një minutë, por fakti që i kishte shpëtuar rrezikut, nuk ishte aspak ngushëllues po të merrte para sysh që gjithë atë verë të bukur do ta kalonte shtrirë mbi shezlong me këmbën në allçi. Të shihte shokët kur luanin, ishte një dënim shtesë për të.

Në fillim, shokët, ushqyen njëfarë kërshërie për atë që kishte ndodhur dhe me pretekstin e firmave sipër allçisë, shkonin te Pjetri për ta pyetur se çfarë kishte ndier gjatë atyre sekondave dhe nëse kishte vizituar botën e përtejme apo nëse kishte takuar Jezusin, Shën Mërinë, djallin, a fundja edhe ndonjë fantazmë.

Për të mos i zhgënjyer, Pjetri përpiqej t'i vinte rrotull të vërtetës, por më pas ndihej i detyruar të pranonte se në terrin ku ishte kredhur, nuk kishte pasur gjë prej gjëje.

Kështu, shumë shpejt interesi rreth tij u zbeh dhe shokët vazhduar me interesa shumë më të përcipta, si për shembull të shijonin dhuratën e mrekullueshme që Perëndia zakonisht u jep fëmijëve: beharin.

Por nga sa dukej, Perëndia nuk donte t'ia dinte aspak për Pjetrin e gjorë, duke qenë nuk do t'i kishte kushtuar asgjë që për shembull, ta detyronte të rrinte pa lëvizur në muajt kur duhej të shkonte në shkollë.

Herë pas here, Ishoja, kushëriri i tij shkëputej nga grupi për ndonjë dorë me letra apo për të luajtur me detektivë, por e bënte më tepër prej dhembshurisë e jo me zemër. Pjetrit i erdhi në majë të hundës ajo lëmoshë, pa folur për torturën e këmbës që i hante e që nuk e kruante dot edhe

nga poshtërimi që i duhej t'i kërkonte Adelas ta shoqëronte në tualet.

Për t'ia lehtësuar lëngatën, i ati, i cili Firencen e bënte çdo ditë vajtje-ardhje për shkak të punës, i kishte sjellë në shtëpi videolojën Nintendo. Por as SuperMario dhe as Luixhi, personazhe e videolojërave dhe shokë të besuar të tij të pasditeve dimërore, nuk ia ngrinin dot moralin. Brenda dy javëve Pjetrit i kishte ikur gjithë e nxira dhe tashmë po shkonte tek e njëjta ngjyrë që kishte pasur në janar.

“Si je sot?” e pyeste herë pas here i ati.

“Më mirë”, përgjigjej ai pa e ditur as në ishte a jo e vërtetë.

Qysh kur për pak desh nuk vdiq në vend, sjellja e prindit kundrejt tij, kishte ndryshuar. Dhe, përtej pyetjes së vagullt që i drejtonte ditë për ditë, kishte filluar ta vrojtonte në një mënyrë të çuditshme.

Pjetri nuk arrinte të kuptonte shumë aspekte të babait. Me të birin ky ishte gjithnjë i rezervuar. Me botën tjetër njeri: i hareshëm e mik i madh. Sidomos me të vegjlit. I ati ishte psikolog fëmijësh dhe pacientët e vegjël e thërrisnin gjithnjë “zoti B.”

Zoti B. ishte gjithnjë i çrregullt. Në dimër vishte një pardesy, si ata komisarët në disa libra policeskë, në verë mbathe sandale të shpifura dhe qesharake. Nëpër xhepa do të mbante gjithnjë lëpirëse dhe tullumbace. Ndërsa me të huajt shpërthente në të qeshura gjëmuese.

Pas aksidentit që mund t'i kishte kushtuar jetën, Pjetri e kuptoi se, përveç mënyrës së veçantë si e shikonte, i ati bënte kujdes edhe t'i qëndronte larg. Pjetri nuk arrinte ta kuptonte se ç'e kishte gjetur vallë. Që nga ajo e hënë e parë

dhe fatale e korrikut, netëve e dëgjonte shpesh të ecte nëpër korridorin jashtë dhomës së tij. Duke numëruar me mendje hapat, e kishte kuptuar se zoti B. mbërrinte deri te pragu. Më pas, ama, nuk e merrte kurrë guximin të hynte.

Pjetri qe përpjekur të përfytyronte arsyen përse i ati sillej me të në një mënyrë kaq të çuditshme. Ndoshta edhe zoti B., njëlloj si shokët e tij, kishte dashur ta pyeste se çfarë kishte përjetuar në ato tridhjetë sekonda kur kishte vdekur.

Donte shumë t'i thoshte se kishte diçka, një shpresë që e priste në anën tjetër. Ndoshta, i ati donte vetëm një përgjigje për të qetësuar dhimbjen e parrëfyeshme, e cila nuk i ndahej qysh kur kishte humbur të shoqen. Ishte e rëndë të bashkëjetoje me një dhimbje të tillë e për më tepër të hiqeshe sikur ishe njeriu më i gëzuar në këtë botë, mendonte Pjetri. Dhe me vete tha se do t'i tregonte ndonjë gënjeshtër vetëm e vetëm që të atit t'i binte shpirti rehat. Por ky nuk i drejtonte asnjë pyetje,

Pasditen e të dielës së fundit të korrikut, zagushia të mbyste dhe të rriturit dremisnin të mbyllur në freskun e shtëpive. Vetëm më të vegjlit i bënëin ballë vapës, që s'do mend dëshirën për të ndenjur së bashku i merrte të keqen. Kështu, nga ora katërmëdhjetë deri në gjashtëmëdhjetë, fëmijët ishin zotët e vetëm të botës.

Ashtu si edhe bashkëmoshatarët, Pjetri nuk e ndiente aspak nevojën të flinte për t'i shpëtuar të nxehtit, por këmba në allçi i diktonte një pushim të detyruar. Nga dritarja e dhomës së tij, me krahët te parvazi ku mbështeste mjekrën, me pamje të pikëlluar, vështronte shokët, të cilët pak metra më poshtë vraponin dhe ndiqnin njëri-tjetrin për ta kapur.

Menjëherë pas aksidentit, prindërit e fëmijëve në shtëpitë fqinje, ua ndaluan lojën e “dyllosjes”. Shumë e rrezikshme, thoshin. Por me kalimin e javëve, ndalimi u harrua. Dhe dëfrimi iu ndaluar zuri vendin e tij mes zbavitjeve të verës e askush nuk u ankua e as u zemërua.

Fati mizor donte që kopshti i Xherberit mbetej ende vendi më ideal për një sfidë mes të gjallëve dhe të dyllosurve. Pas asaj që i ndodhi Pjetrit, brenda shtëpisë loja u ndalua përfundimisht. Por jashtë, në labirintet e gëmushave me lule voshtë e po ashtu edhe të bimëve zbukuruese, mund t’u ofronin fëmijëve vende të përsosura për t’u fshehur.

Pa e vrarë mendjen për ato çka do ndiente shoku i tyre i lënduar, kur t’i shihte si do të zbaviteshin pa fre, shtatë të mbijetuarit e grupit luanin si të tërbuar. Mes tyre ishte madje edhe Karleto, i cili më në fund, kësaj here, arriti t’u shpëtonte detyrave të algjebrës dhe kontrollit të së ëmës. Kësisoj mungonte vetëm Pjetri, i cili kishte një grimë zili dhe pa fund mërzi. Ngushëllimi i vetëm ishte se nga ai pozicion i privilegjuar kishte fushëpamjen më të përkryer të garës, e cila po zhvillohej pa pjesëmarrjen e tij.

Roli i të dyllosurit të parë i takoi Dantes, i cili kapi menjëherë Xhovanonen, por skena që pa Pjetri tregonte krejt tjetër gjë. Shoku i tij i bëshëm nuk arrinte thujse kurrë ta fshihte vëllimin trupor dhe praktikisht i ishte dorëzuar armikut. Tani, ata të dy këmbenin informacione mbi vendndodhjen e mundshme të pjesëmarrësve të tjerë. Në bazë të rregullit kjo duhej kryer vetëm me fishkëllima

Pjetri arriti në përfundimin se Debora kishte gjetur një vend të mirë për t’u fshehur pas një pirlu shkarpash, të mbledhur nga zoti B. kur kishte pastruar kopshtin. Ishoja

dhe Karletoja, po ashtu ishin fshehur mirë, ndërsa Etores do t'i vinte radha të kapej shpejt. Xenoja i vogël, i cili parimisht në atë lojë do të kishte pasur përparësinë e shtatit prej fëmije pesë vjeç, ishte ende i pavendosur për vendin ku do të fshihej dhe sillej i hutuar me bluzën e përhershme bojë vjollcë të Batigolit, e cila e bënte të dallohej përnjëherë.

Në përgjithësi, në fillim gjithçka vijonte qetësisht. Por, mu në çastin kur numri i të dyllosurve dilte mbi atë të të gjallëve, loja ndizej dhe çfarë nuk mund të bënte vaki.

Pikërisht kjo ndodh kur skuadrës së të dyllosurve iu bashkua Etoja me Karleton. Debora u pikas dhe u orvat t'ia mbathte, por përfundoi e rrethuar. Tanimë nuk kishte nga t'ia mbante. Natyrisht, çdo kapje shoqërohej me një buçimë të qeshurash. Dhe ishte pikërisht ky çast ai që e lëndonte më tepër Pjetrin e dëmtuar. Kur më në fund u kap edhe Ishoja, të gjithë vështruan njëri-tjetrin të habitur.

Nga sa dukej, i gjalli i fundit i mbetur ishte Xeno Zanusi.

Më i vogli i grupit e kishte pasur një herë nderin të shqiptonte fjalën “Arimo”, por vetëm sepse herë pas here të tjerët ia kishin dhënë bujarisht të drejtën e gëzimit të fitores. Dhe ai, nga ana e tij nuk i kishte shkuar as prej së largu ndër mend se këtë ia kishin bërë si favor.

Ama, deri në atë fazë nuk kishte arritur kurrë pa ndihmën e tyre.

Gjashtë pjesëtarët në kopsht nisën të fërshëlleni për të shprehur habinë e përbashkët. Njëkohësisht, u ndanë për të gjetur të mbijetuarin e fundit, i cili siç parashikohej do të gudulisej deri sa t'i dilyn lot përpara se të shqiptonte fjalën magjike, e cila do t'i jepte fund konfliktit dhe rregullit të heshtjes së detyruar bashkë me kërcënimin për një vdekje

të dhunshme brenda tri ditësh nëse ndokush do të guxonte të fliste përpara “Arimo”-s

Nga pozicioni i tij, Pjetri, ndonëse në pamundësi të merrte pjesë në dëfrim, ndihej i lumtur për Xenon.

Ky duhej të ishte fshehur mirë, duke qenë se të dyllosurit nuk arrinin ta gjenin dot. Minutat kalonin dhe tashmë, ata të gjashtë në kopsht, besonin se do ta shihnin të dilte nga njëri çast në tjetrin. Bluza ngjyrë vjollcë prej kampioni do të ishte e përsosur për triumfin që e priste

Por në atë pasdite të zymtë të një të diele korriku si gjithë të tjerat, nuk dyshonin ende se Xeno Xanusi nuk do të dilte më kurrë për të çliruar të tjerët. Dhe, se nuk do të vononte shumë dhe ajo zonë e qetë verimi, do të mbushej me makina me drita verbuese e njerëz me uniformë, të cilët do t’u bënin një milion pyetje.

Nuk e merrnin dot me mend se në ditët dhe javët në vijim, grupe vullnetarësh do të krihnin pa pushim zonën me pyje që rrethonte Porto Erkolen. Dhe se fotot e shokut të tyre të vogël pesë vjeç do të dilnin, madje edhe në televizione.

Nuk e dinin as se në vitet që do të vinin, në rastin e përvjetorit të zhdukjes, në fshat do të mbahej një meshë për t’i kërkuar Perëndisë që të paktën t’u tregonte diçka prindërve dhe vëllait të madh që mësonin të vërtetën mbi fundin e vogëlushit. Xeno Xanusi, ndryshe Batigoli, nuk do të kthehej kurrë më për të shqiptuar “Arimo”-n. As te kopshti i shpresës së humbur dhe asgjëkund tjetër. Dhe miqtë e tij do të mbeteshin robër të mallkimin të lojës së dyllosjes.

Përgjithmonë.

Të gjithë. Madje, edhe Pjetër Xherberi.

I

23 shkurt

- Tomi, a ma tregon edhe një herë atë historinë e vizatimit?

- Të duhet vërtet?

- Po, të lutem.

- Ishim në pushimin e madh. Nuk dolëm në oborr sepse binte shi, atëherë ndenjëm në klasë për të ngrënë bukën bashkë me mësuesen.

- Dhe ishin të gjithë shokët e tu?

- Federiku dhe Gaja kishin shkuar në tualet, - tha fëmija.

Pjetër Xherberi shënoi në bllok atë të dhënë në dukje të parëndësishme. Saktësia e Tomazos tregonte se e kishte më se të qartë skenën e projektuar në ekranin e qepallave të ulura.

Pacienti i vogël ishte kredhur i tëri në atë përjetim hipnotik. Vështronte me sy e me mendje.

- Atëherë, çfarë ndodhi? - e shtyu terapeuti ndërkohë që metronomi elektronik rrihte saktësisht kohën duke krijuar një gjendje shtendosjeje.

- Xhulioja vizatoi një gjirafë në dërrasën e zezë, pastaj kthye dhe tha: “Kjo është Xhinevra”.

- Ngaqë Xhinevra është shumë e gjatë, apo jo?

- Më e gjata në gjithë klasën, - e përforcoi pacienti i vogël duke vazhduar të tundej në karrigen përkundëse. - Qeshëm të gjithë pasi ishte e vërtetë. Qeshi edhe mësuesja.

- Po Xhinevra, a u fye që e krahasuan me gjirafën? - pyeti Xherberi i ulur në kolltuk e që ndërkohë vëzhgonte me vëmendje edhe reagimin më të vogël të Tomazos.

- Jo, madje ajo qeshte bashkë me ne.

- Po më pas, çfarë ndodhi?

- Xhulioja vazhdoi me vizatimin: Luka ishte tigër, Manueli gorillë, Virxhinia zebër... - Teksa përmendte shokët e klasës Tomazo dukej i qetë.

Psikologu për fëmijë vazhdonte të mbante shënime: fjalë të shpejta me stilolaps mbi fletët e ashpra dhe elegante si të prera me shpatë.

- Po ku erdhi radha jote?

Fëmija u bllokua në çast.

- Xhulioja tha se unë isha zog.

- E përse zog?

- Nuk e di, - pranoi vogëlushi, me një ngërdheshje bezdie.

Xherberi rreshti së shkruari dhe me dorën, me të cilën shtrëngonte stilolapsin, ngriti syzet mbi ballë.

- Nuk është gjë e keqe të të krahasojnë me një zog, - i tha me bindje. - Zogjtë mund të fluturojnë dhe ma do mendja që duhet të jetë bukur ta shohësh botën nga aty lart, apo jo?

- Zogjtë bëjnë glasa sipër njerëzve dhe gjërave, - ia ktheu fëmija i acaruar. - Dhe pastaj unë doja të isha luan, - përfundoi qejfprishur.

Një sjellje e tillë ishte krejt e kuptueshme për moshën shtatëvjeçare dhe Xherberi nuk do t'i jepte peshë të madhe reagimit, sikur të mos e pushtonte dyshimi se, në të vërtetë, pas tij fshihej diçka tjetër. Në fakt, duke shqiptuar ato fjalët e fundit, toni i Tomazos kishte ndryshuar, duke e humbur pafajësinë e fëmijërisë dhe duke marrë një tingëllim më mllefqar.

Ky nuk ishte më zëri i një fëmije.

Tanimë, pas disa seancash, psikologu kishte filluar të përndijonte shenjat e diçkaje, e cila lëvizte në brendësi të psikikës së pacientit të vogël.

Një zemërim i panatyrshëm për atë moshë.

Kjo nuk ishte hera e parë kur ndeshej me një rast të tillë. Kishte pasur të bënte edhe në të kaluarën. Dhe nuk i pëlqente aspak.

Studioja në papafingon e pallati të vjetër, pak hapa larg sheshit “*Sinjoria*”, ishte si një prehër i ngrohtë dhe i dashur për fëmijët që hynin e që uleshin tek e njëjta karrige përkundëse, ku tani po rrinte gjysmë i shtrirë Tomazo. Oxhaku i ndezur, trarët prej druri, libraria e madhe, tapeti i kuq me lodrat andej-këndej sipër, fletët dhe lapsat me ngjyra, ishin vendi i përsosur për të rrëfyer një përrallë të bukur. Vetëm se në atë dhomë, fëmijët ishin rrëfimtarë dhe shpesh, historitë e tyre ishin të mbushura me përbindështa të fshehtë dhe, në ndonjë rast nuk kishin fund të lumtur.

Përveç Pjetër Xherberit, të pranishëm ishin edhe disa spektatorë të heshtur. Pelushë, kukulla, lodra me personazhe filmash brenda të cilëve fshiheshin sy të vegjël elektronikë, të cilët regjistronin seancat. Pasi i kridhte pacientët e vegjël në veten e tyre, me ndihmën e një metronomi apo

të ndonjë teknike tjetër shtendosjeje, nëpërmjet zërit të tij, hipnotizuesi fillonte një proces të caktuar orientimi, duke zgjedhur me kujdes fjalët në mënyrë që ata të ndiheshin gjithmonë të mbrojtur e të sigurt.

- Dhe ti do të doje të ishe luan, - pohoi duke ritheksuar dëshirën e Tomazos.

- Po, dua.

- Dhe si do të ndiheshe po të ishe zog?

Pacienti nuk pati nevojë të mendohej gjatë.

- Më vjen inat, - tha. Fytyra iu shformua nga një skërmitje zemërimi dhe shtrëngoi grushtet.

- Inatin e ke me Xhulion, shokun tënd? - vazhdoi ta provokonte Xherberi.

- Po.

- Do të doje ta kapje me grushte apo që t'i bërtiste mësuesja?

Hipnotizuesi la të kalonin disa sekonda e më pas vazhdoi.

- Nuk të duket pak e tepruar? Fundja, mua nuk më duket se shoku yt bëri ndonjë gjë kushedi sa të rëndë.

Kësaj radhe fëmija nuk u përgjigj.

Një muaj më parë, prindërit e Tomazos i ishin drejtuar Pjetër Xherberit, pasi djali vazhdonte të bënte ujët në shtrat. Një problem i tillë, zakonisht zgjidhej brenda pak seancash.

Por qysh pas seancës së parë, psikologu kishte kuptuar se diçka nuk shkonte. Nën hipnozë, vogëlushi shfaqte një agresivitet të ndrydhur e të paarsyeshëm, i cili gjithnjë e më shpesh manifestohej me pohime armiqësore të ngjashme me atë që sapo kishte thënë në lidhje me shokun e shkollës.

Në thelb, të gjitha lidheshin me arsye të kota, shpesh fëmimore. Xherberi kishte pyetur familjarët mos rastësisht

në lagjen e tyre kishte ndodhur ndonjë akt vandalizmi dhe autorët nuk ishin gjendur, apo nëse kohët e fundit kishin pasur ndonjë aksident në familje. Babai i Tomazos i kishte konfirmuar se në vilën e vogël ku banonin, në një lagje të jashtme të Firences, kishte rënë një zjarr, i cili për fat ishte shuar shpejt. Burri nuk e kuptonte se ç'lidhje mund të kishin këto ndodhi me ujët e hollë që djali shtatëvjeçar bënte ende në shtrat. Nga ana tjetër, si mund të jepte një shpjegim?

Këto sinjale mund t'i interpretonte vetëm një specialist. Simptomat ishin ato të urinimit në shtrat natën dhe të piromanisë.

Më pas Xherberi kishte pyetur nëse mbanin kafshë dhe iu përgjigjën se motra e vogël e Tomit, kishte një akvarium me peshq të kuq, por duke qenë se këta nuk mbijetonin më shumë se një javë, nuk blinin më.

Këto të dhëna terapeuti i mbledhi në mënyrë që të fillonte me përpilimin e kuadrit klinik, por duke mos qenë ende i sigurt për diagnozën, guxoi të shtyhej më tej: - Tomi, ata peshqit e motrës, ti i ke mbytur?

- Po, - e pranoi pa asnjë problem fëmija që gjendej nën hipnozë.

- E përse e bëre?

- Nuk e di, - u përgjigj çiltërsisht.

Por Xherberi ishte i bindur që po e gënjente. Djali i vogël a e dinte që ç'ke me të, sado që gjendja e transit favorizonte relaksim e mekanizmave frenues. Psikika e tij e mbante informacionin përbrenda. Nga sa dukej, Tomi e zotëronte ende aftësinë për të gënjyer e për të fshehur. - Si i vrave peshqit? Do të ma tregosh?

- Futa njërin krah në ujë dhe i kapa me dorë, - shpjegoi thujtse me kryeneçësi. - Ata më rrëshqisnin, por nuk i shtrëngoja fort.

- E përse?

- Sepse ata do ta kuptonin...

- Cilët ata? Prindërit?

- Po, mami dhe babi nuk duhet të kuptojnë që e kam bërë unë. Kështu, e mbaja peshkun në dorë dhe e shikoja deri sa pushonte së lëvizuri.

Xherberi shkroi në bllok: “Aktin e paramendon: përlllogarit me kujdes rreziqet dhe sajton mënyra për të fshehur provat me synimin të parandalojë pasojat e mundshme.”

- Çfarë ndjeve kur pe atë peshkun që po të vdiste në dorë?

Fëmijës, pavarësisht se rrinte gjithë kohë pa lëvizur, frymëmarrja iu shpeshua dhe bebëzat e syve i lëviznin në mënyrë të furishme. Xherberi e dinte çfarë do të thoshin ato reagime. Gjuha e trupit

nuk mund të interpretohej dot ndryshe. Fërgëllimë.

- Nuk të erdhi keq për peshkun e gjorë? - e nxiti.

- Jo, - tha Tomazo, duke gëlltitur pështymën që i ishte bërë si shukmë në gojë. - Më pëlqen ta shoh.

Psikologu shkroi: “Mungesë empatie, sadizëm.”

Xherberi mbylli bllokun me kapak të zi dhe e mbështeti mbi gju. Nuk do të vononte dhe do të shkonte ta vendoste në vendin e vet, te rafti i arkivit të fshehtë bashkë me atë të pacientëve të tjerë. Aty ruante edhe blloqet e vjetër, njëlloj siç kishte vepruar edhe i ati përpara tij.

Me një ndjenjë zhgënjimi qëndroi të vështronte Tomin e vogël. Ndonjëherë, edhe qenia më e pafajshme, mban brenda vetes një thelb potencialisht të lig. Askush nuk i kishte dhënë dot një shpjegim klinik kësaj, por tek ai fëmijë vërtitej një prani e errët.

Një Tomi tjetër, i cili priste vetëm rastin e duhur për t'u shfaqur.

- Ti nuk do t'i bëje kurrë keq motrës tënde vogël, apo jo, Tomazo? - e pyeti doktor Xherberi duke e ditur tashmë se cilado që të ishte përgjigja, nuk duhej t'i besonte.

- Unë nuk do t'i bëj kurrë keq motrës së vogël, - tha fëmija me një ton sikur po hapte rrugë, të bënte të dyshoje se thjesht kishte përsëritur atë që i rrituri donte të dëgjonte prej tij.

Hipnotizuesi po mendohej si të vepronte. Nuk ishte e thjeshtë. Tomazon duhej ta vinte në një procedurë jo tamam korrekte, e cila tejkalonte kufijtë e deontologjisë profesionale. Por, të paktën, kështu do të kishte diçka për t'i ofruar atij fëmije.

Fillim nga e para, tani e quante Zoti B.

- Unë të besoj Tomi, - i tha në lidhje me pohimin që nuk do t'i bënte keq të motrës. Pak rëndësi kishte nëse fjalët e Xherberit nuk përkonin me atë që mendonte në të vërtetë. Donte ta siguronte djalin e vogël, sado që tashmë e kishte bërë zgjedhjen. - Por tani, më duhet të të zbuloj një sekret.

- Çfarë sekreti? - e pyeti me kureshtje fëmija.

- Peshqit nuk i ke vrarë ti.

- Ashtu? - pyeti Tomazo i habitur.

- Në të vërtetë nuk ka ndodhur kurrë. Ka qenë thjesht një ëndërr.

- Ëndërr? - Djali dukej dyshues.

- Ëndërr e keqe, - konfirmoi Xherberi duke gënjyer. - Kështu, tani do të të shpjegoj çfarë do të bëjmë sepse dua të të ndihmoj ta harrosh.

Asnjë reagim nga Tomi.

Ndër psikologët, fshirja e kujtesës nën hipnozë ishte një praktikë e ndaluar. Disave u dukej jo korrekte moralisht, pasi përbënte një ndërhyrje të rëndë në vullnetin e pacientit.

Por hipnotizuesi, mendoi se nuk humbiste asgjë. Duke parë edhe situatën, as Tomazo. Dhe duke qenë se episodi me peshqit e kuq mund të shkaktonte sjellje të tjera të dhunshme, ishte e drejtë që këto të eliminoheshin.

- Nëse e ke kuptuar mirë, përsërit atë që sapo të thashë, - e ftoi Xherberi.

- Duhet të harroj që vrava peshqit e kuq, - pohoi me saktësi të madhe fëmija.

- Bukur. Pikërisht kështu.

Shpresonte që fshirja e një ngjarjeje të vetme do të shkaktonte një reagim zinxhir në mendjen e Tomit, duke devijuar rrugëtimet logjike, të cilat e kishin shtyrë të vriste ata peshq të gjorë.

Hipnotizuesi nuk mund t'i shtypte krejtësisht instinktet e fëmijës, por mundej ende t'i frenonte, duke i shtyrë në honin e psikikës, aty ku formoheshin impulset në të këqija të njerëzve.

- Tani, do të numërojmë të dy së prapthi duke nisur nga numri dhjetë, - i tha Xherberi. - më pas, do të të duket sikur je zgjuar në mëngjes në shtratin tënd. Do të hapësh sytë dhe ëndrra e keqe do të jetë zhdukur.

- Zhdukur, - përsëriti pacienti.

Në fund të numërimit, fëmija hapi sytë dhe u kthye drejt tij.

- Atëherë, si shkoi? - e pyeti me ankthin që të dinte nëse kishte marrë a jo notë të mirë. Nga çfarë kishte ndodhur gjatë hipnozës nuk mbante mend asgjë.

- Shkoi shumë mirë, - ia konfirmoi hipnotizuesi dhe Tomi bëri një buzëqeshje të mrekullueshme duke zbuluar gojën pa dhëmbë. *Mendjen e ka ende të përpunueshme*, tha Xherberi mesveti. *Jemi ende në kohë*, u përpoq t'i mbushte mendjen vetes. Tomazo ishte një fëmijë tepër i butë dhe ajo që po i ndodhte ishte tepër mizore.

Pacienti i vogël u ngrit nga karrigia lëkundëse dhe shkoi të merrte çantën e palestrës bashkë me xhaketën sportive te varësja përbri derës. Dukej i shkujdesur.

Ndërkohë që ishte me kurriz, psikologu e pyeti sërish:

- Ti nuk do t'i bëje kurrë keq motrës së vogël, apo jo, Tomazo?

Fëmija zgurdulloi sytë i habitur.

- Jo, kurrë, - tha me një bindje të dukshme.

Për momentin Tomazoja ishte pacienti i tij i vetëm. Por kjo nuk kishte qenë zgjedhje e Pjetri Xherberit.

Jo shumë kohë më parë, psikologu gëzonte vlerësim të madh në rrethet profesionale. Angazhimeve private u shtoheshin edhe ato të konsulencës për Gjykatën e të miturve, ku atij i besoheshin rastet më delikate. Por tashmë, në derën e tij nuk trokiste më kush. Tek ai nuk besonte njeri. Në lidhje me të ishin përhapur fjalë. Thoshin se kishte “shterur”, se nuk ishte më në gjendej të ushtronte profesionin.

Pavarësisht se mbiemri Xherber ruante ende njëfarë autoriteti, dukej se reputacioni i tij tanimë kishte marrë tatëpjetën dhe si një fryt që bie, fillon edhe të kalbet. Nuk kishte ndodhur përnjëherë, por pak e nga pak.

Pas rastit të Trilluesit, Xherberi nuk ishte më vetvetja. Dhe këtë e kishin vënë re të gjithë.

Pikërisht kështu e kishte quajtur armikun e betuar të tij dhe atij personi i dinte vetëm tri germa nistore të mjera.

A. D. V.

Mendjen e një fëmije, të cilin nuk kishte arritur ta shpëtonte dot, me vete e kishte përkufizuar si “shtëpi pa kujtime”. Dhe ideja e dështimit të tij më të madh si terapeut, kishte filluar ta përndiqte

Në të vërtetë, nuk pati qenë në gjendje të dallonte shenjat e para të rënies. Gjithçka kishte filluar nga lidhësja e një këpuce, e cila iu këput një ditë të bukur. E pat vështuar për disa sekonda me një ndjesi pafuqie të pashpjegueshme. Nuk qe ndonjë gjë e madhe, faktikisht, por në atë çast, atij iu duk si një problem i pakapërcyeshëm.

Fundi i botës fillon me një kërcitje, thoshte shpesh e me dëshirë zoti B.

Atë ditë Xherberi e kaloi duke i lënë pa lidhur dy kombet sipër e mandej doli duke thënë me vete se në rastin më të parë do të blinte lidhëse të reja. Por nuk e bëri.

Muajt kalonin dhe këpuca e majtë “*Klarks*” vazhdonte me lidhësen e këputur.

Që nga ai çast Xherberi e lëshoi veten. Lidhëses iu shtuan edhe flokët gjithnjë të shprishura, mjekra e parruar. E gjithë panorama plotësohej me veshjet përherë të zhubrosura apo me njolla, bërrylat e bluzave të ngrënë e me dorëzat dhe jakat e këmishëve me fije të dala

Edhe higjiena personale linte për të dëshiruar. Pjetri mbetej gjithmonë një burrë i pashëm, por ai nur, që gjithmonë i kishte shërbyer si mburojë ndaj gjykimeve të tjerëve, tani dukej se nuk pinte më ujë.

Veç kësaj, më e keqja ishte se dukej sikur as nuk e vinte re ç’po i ndodhte. Rreth tij ishte krijuar një si punë fluske

e padepërtueshme prej gome, e cila ia mbante larg njerëzit e ia shtynte tej.

E vërteta ishte se ndërkohë që thekej në dembeli, kishte humbur dëshirën për punën si psikolog. Mungesa e interesit i pasqyrohej edhe në pamje. Tashmë, ai as nuk e vinte re gjendjen ku e kishte katandisur veten. Nuk ishte më i sigurt në asgjë. Gjatë atyre muajve pa asnjë pacient, kishte pasur gjithë kohën për të bluar me vete me rastin e Trilluesit. Dhe pas brerjes së ndërgjegjes, i erdhi radha apatisë.

Kjo ishte arsyeja përse me Tomazon nuk kishte pati skrupuj që të ndiqte procedurën e ndaluar të fshirjes së kujtesës.

Seancën e mbylli pak pas orës pesë pasdite dhe ca më vonë Xherberi kishte një takim jashtë studios ku nuk mund të mungonte në asnjë mënyrë.

Shoqëroi Tomazon te dera. Në paradhomë gjendej babai i djalit të vogël. Me t'i parë, ky u ngrit nga kolltuku i vogël ku po priste prej gati një ore dhe kërkoi fill vështtrimin e psikologut. Në sy i lexohej një pyetje e heshtur.

- Gjithçka në rregull, - i doli përpara Xherberi duke gënjyer. - Terapia po shkon për bukuri, - shtoi duke fërkuar kokën e Tomit, i cili u shty për të marrë një banane nga kaçilja e frutave në dispozicion të pacientëve të vegjël.

Fakti që Tomazo ishte i vetmi që i kishte mbetur, për psikologun nuk ishte arsye e vlefshme ta ndërpriste atë traditë.

- Shihemi pas pesëmbëdhjetë ditësh, - i tha, duke besuar se zemërimi që i gëlonte në fshehtësi do të mbetej i mbyllur mirë në psikikën e tij feminare.

Pak më pas, Tomi u largua nga papafingoja bashkë me të atin.

Xherberi u kthye në studio duke i hedhur një sy orës. Vrau mendjen nëse do të arrinte në kohë dhe nëse personi, me të cilin kishte lënë takim pas pak në Kafe Paskovski do t'ia toleronte vonesën. Nuk e dinte as ç'pamje kishte. Sipas udhëzimeve të marra, tjetri do të merrej vesh kush ishte duke vendosur mbi tavolinë një orë me qostek.

Ndërkohë që ngutej të fikte zjarrin në oxhak, të shuante dritat dhe të mbyllte qepenat e dritareve, llamba e kuqe në tavan, e lidhur me një buton te muri i sallës së pritjes, u ndez dhe u shua dy herë.

Sinjali i heshtur shërbente për të njoftuar mbërritjen e dikujt pa prishur seancën.

I bezdisur ngaqë i erdhi papritur dhe me synimin që të ndahej me shpejtësi nga mysafiri i paftuar, Xherberi u dha te dera.

Në mes të korridorit, në gjysmëhije, ndodhej dikush, i cili ishte shtyrë shumë më tej pa e ditur se po qëndronte para derës së mbyllur të studios së dikurshme të zotit B.

- Kush jeni? - pyeti psikologu figurën që rrinte e stepur e që dukej se vështronte në drejtim të tij.

- Quhem Maja Salo, - u përgjigj një zë rinor e me theks të huaj.

- Duhet të lini takim, - e qortoi Xherberi duke parë se tjetra kishte ardhur vetëm. - Dhe biseda e parë zhvillohet gjithmonë në prani të pacientit apo pacientes.

- Eva nuk është ime bijë, - saktësoi ajo, sado që nuk ia kishte kërkuar kush.

Më pas, u afrua një hap drejt tij dhe Pjetrit iu dha mundësia ta shihte më mirë. Kishte veshur një pallto *Montgomeri* ngjyrë blu, një fund skocez, çorape të errëta dhe këpucë me taka të ulëta. Qafën e hollë ia mbështillte një shall i madh leshi, cepat e të cilit i mbërrinin gati deri te gjunjët. Flokët kaçurrela e të kuq, jo shumë të gjatë. Quka dhe sy të gjelbër. Tregonte pak më shumë se njëzet vjeçe. Tipare të një bukurie të pafajshme dhe të pamëshirshme.

- Nuk kam kohë t'ju pres tani, kaloni nesër, - u përpoqa ta përcillte Xherberi me mirësjellje të shtuar.

- Ju lutem, unë banoj jashtë Firences dhe për të ardhur këtu më duhet të marr tre autobusë, - gati iu përgjërua tjetra.

- Përse nuk më telefonuat më parë? - e pyeti ai me një ton qortues. - Do t'jua kisha kursyer rrugën.

Vajza nguroi.

- Sepse kisha frikë që me telefon nuk do të më besonit.

E uli në studio. Në zërin e Maja Salos, Xherberi dallonte tingëllimin e një dëshpërimi të fshehur. Gjatë karrierës së tij ishte hasur disa herë me këtë. Vështroi orën:

- Kam vetëm pak minuta, - e paralajmëroi sertë. Për t'ia theksuar ngutin nuk u ul dhe as nuk e ftoi të ulej.

Vajza bëri disa hapa dhe ndali në qendër të dhomës, ndërsa psikologu u mbështet me ije te shpinorja e karriges së tij "*Eames Lounge Hair*" me lëkurë të zezë dhe dru palisandri.

- Atëherë ma thoni edhe një herë kush jeni ju e mandej më shpjegoni edhe kush është Eva, - i ra shkurt.

- Unë studioj për arte dhe kam ardhur pesë muaj më parë nga Helsinki për një temë diplome mbi Çimabuen, - ia nisi duke qëndruar gjithë ngërç e pa ditur ku të vinte duart.

Pjetrit iu duk se parfumi delikat, që përhapte i ngjante shumë asaj vetë dhe ndjeu që ajo aromë po i pëlqente. *Ujë trëndafili*, tha me vete, duke qenë se qysh fëmijë i njihte të gjitha esencat për shkak të koleksionit të nënës.

- Italishten e folkeni mirë, - e përgëzoi, por vetëm ngaqë iu duk e pazakontë kadenca e Firences.

- Mbaj mbiemrin e nënës, por babai ishte nga Areco. Në Finlandë, në kërkim të fatit emigroi fare i ri.

Nga mënyra si e tha, psikologu mori me mend se nuk duhej ta kishte gjetur.

- Po ju, ku jetoni aktualisht? M'u duk se kuptova që nuk banoni këtu në qytet.

- Në një pronë në zonën e San Xhiminjanos, - i konfirmoi Maja. - I përket familjes Oneli Katelani.

Nuk ishte e nevojshme të njihje emrin për të kuptuar se mbiemri i dyfishtë shpesh dëshmonte për origjinën aristokratike. Xherberi e dinte se në Toskanë ekzistonin familje me pasuri të papërfytyrueshme e me origjinë të vjetër që s'ia gjeje dot fillimin

Tashmë titujt e fisnikërisë të atyre të privilegjuarve të pleksur me njëri-tjetrin nuk kishin asnjë peshë dhe pasuritë mund të krahasoheshin me ato të industrialistëve, oligarkëve, bankierëve, yjeve të sportit dhe të spektaklit. Por, në dallim nga këta të fundit, aristokratët nuk kishin punuar një ditë të vetme në jetën e tyre. Lindnin në kamje e në kamje vdisnin. Pa e ditur as përse dhe ndonjëherë, pa e vrarë, as mendjen për tërë jetën.

- Ju jeni fis me vajzën e vogël? - e pyeti

- Kujdesem për të, - pohoi vajza.

- Dadoja?

- Më ofrojnë strehimin dhe ushqimin, - saktësoi Maja Salo. - Punën e gjeta nga një njoftim në faqen e universitetit

Shpesh, kështu kryheshin punësimet nga jashtë të vajzave apo djemve "kundrejt strehimit dhe ushqimit"

mendoj Xherberi. Familje të ndryshme ofronin banesën, ushqimin dhe një pagë të vogël. Në këmbim, këta ndihmonin në aspekte të nevojave të përditshme, veçanërisht për të mbajtur fëmijët e vegjël. Nga ana e tyre studentët kishin mundësi të udhëtonin dhe të përballonin shpenzimet duke kryer edhe një përvojë në një vend tjetër.

Në këtë mes Xherberi kishte të paqartë një aspekt.

- Dhe prindërit e Evës ju dërguan tek unë? Përse nuk erdhën personalisht?

- Burrë e grua janë të ndarë. Besoj se i ati prej shumë kohësh jeton gjatë dhe nuk do t'ia dijë për familjen. - Bëri një pauzë. - Zonja Beatrice udhëton nëpër botë dhe dëgjohemi vetëm me telefon. Tani që po flasim gjendet në kroçerë në Barbados.

Xherberi mbeti i habitur nga përshkrimi i familjes së Evës.

- Në mos gabohem, sapo më thatë që me të ëmën dëgjoheni vetëm me telefon? - e pyeti duke e theksuar frazën, e cila kishte mbetur disi e paqartë nga konteksti.

- Po, - konfirmoi vajza. Më pas, duke e kuptuar habinë e tjetrit shtoi: - Kam jetuar edhe në familje të tjera si puna e kësaj dhe nuk është hera e parë që më ndodh. Ekzistojnë prindër, të cilët nuk kanë kohë të merren drejtpërdrejt me fëmijët dhe preferojnë t'ua besojnë personave të huaj si puna ime. Në fillim, kjo largësi më çudiste, por jam mësuar të mos t'i gjykoj sepse ma do mendja që kështu do të ketë qenë edhe për ta gjatë fëmijërisë. - Maja Salo tundi kokën dhe buzëqeshi paksa me dhëmbët tejet të bardhë. - Madje, duhet të them se Beatricja interesohet për të bijën shumë më tepër se shumë nëna të tjera që kam njohur në të kaluarën.

Aty për aty, Pjetri e mori si të natyrshme përgjigjen, sado që nuk ishte krejtësisht i bindur.

- Po tek unë kush ju drejtoi, zonja Beatrice Oneli Katelani?

- Ideja ishte imja. Pyeta rreth e rrotull dhe më thanë se ju jeni më i miri, - theksoi vajza dhe i nguli sytë. - Gjumëvënësi i fëmijëve, drejt e kam?

Psikologu hipnotizues donte të konfirmonte nëse informacioni i marrë ishte me bazë dhe nëse ajo lëvdatë ishte plotësisht e merituar. Por nuk mundej. Nuk ishte e vërtetë.

- Eva është dhjetë vjeçe, - tha Maja, ndoshta duke vënë re se ngrysjen e bashkëbiseduesit.

Xherberit iu kujtua justifikimi që vajza kishte përdorur pak më parë që të përlligjte faktin se atje kishte shkuar me vullnetin e saj personal.

Ngaqë kisha frikë se me telefon ju nuk do të më besonit.

E pushtoi ndjesi bezdie. Duhej të mos tregohej tepër i interesuar për këtë rastësi, pasi duke u nisur nga fillesat, nuk e kishte ende të qartë që mund të merrej.

- Cili është problemi i Evës? - e pyeti.

- Nuk dëgjon të dalë jashtë shtëpisë ku ka lindur dhe ku është rritur.

- E kanë diagnostikuar ndonjëherë me agorafobi infantile?

- Sipas të ëmës, mjekët të cilëve u është drejtuar nuk kanë kuptuar kurrë asgjë... Por unë kam qenë personalisht e pranishme gjatë një krize të Evës: nëse dikush e detyron me forcë të dalë, atë e kap menjëherë paniku, bërtet dhe përpëlitet.

- Prandaj Eva nuk shkon në shkollë dhe nuk shoqërohet me fëmijë të tjerë.

Maja Salo tundi kokën. - Me shkollimin e saj merrem unë dhe kryesisht për këtë më kanë pajtuar.

- E përse nuk do t'ju besoja në telefon? - e pyeti Pjetri.

- Sepse është shtuar edhe një problem tjetër, - u përgjigj Maja duke fituar kohë. - Eva ka një shok imagjinar, - tha me një frymë. - E di që ju do më thoni se kjo është e përhapur, veçanërisht në atë moshë.

Nuk ishte. Madje shpesh shërbente si tregues për diçka më serioze. Këtë Xherberi e mbajti për vete.

- Vazhdoni... - e ftoi, duke parë orën në mënyrë që tjetra të kuptonte se nuk i mbetej shumë kohë.

- Në fillim mendoja se ishte thjesht një lojë si shumë të tjera, - vazhdoi vajza. - Besoja se ajo fantazi vinte nga fakti që Eva nuk kishte kontakte me moshatarë. Prandaj ia bëja qejfin duke menduar se nuk kishte asgjë të keqe

Në fakt, nuk duhej të kishe vepruar kështu, tha Xherberi me vete duke i kaluar një rrëqethje në trup.

- Bie fjala, pasdite, zemrën e përgatisja për dy apo në mbrëmje lija dy gota ujë mbi komodinë ... Por Eva nuk më lejonte kurrë t'i drejtohesha drejtpërdrejt fëmijës, madje nervozohej nëse me shaka përpiqesha të ndërveproja me të. Thoshte se ai nuk donte të kishte të bënte me mua dhe se po ta provoja përsëri, shoku i saj do të ma tregonte vendin.

Ky detaj ishte shqetësues.

- A i ka vënë ndonjëherë në zbatim kërcënimet vajza?

Vajza pohoi me kokë e tronditur.

- Janë zhdukur disa sende të mia, gjëra me pak vlerë: një varëse korali, një buzëkuq, ndërsa në një rast edhe një

këpuçë atletike. Nuk mund të jem e sigurt se e ka bërë Eva, por përkimi është tepër i dukshëm.

Xherberi nuhati se në këtë mes kishte edhe më tepër se kaq dhe se pjesa tjetër e rrëfimit duhej të fshihte diçka akoma edhe më alarmuese.

- Shpresoja që kjo lojë t'i mërzhitej shpejt, pasi nuk dija si ta mbaja situatën nën kontroll. Por tashmë është kthyer në një obsesion. - Maja Salo të jepte idenë se ishte vërtet e shqetësuar dhe në ankth. - Duke u munduar që ta hutoja, duke sajuar mënyra të tjera për të kaluar kohën apo për të ndenjur me të, por Eva më dëbonte në mënyrë që të mbetej vetëm me shokun imagjinar. Mbyllej në dhomë dhe unë e ndieja që fliste me orë të tëra e vetme

Psikologu e dinte se tani vinte edhe më e keqja. Vajza dukej sinqerisht e tmerruar.

- Ndonjëherë ndodhte Eva zgjohej në mes të natës dhe niste të luante me të.

Shokët imagjinarë të fëmijëve dilnin nga thellësitë e puseve të vetmisë, mendoi Pjetër Xherberi. Molepsnin gjithçka me praninë e tyre të neveritshme, ishin despotikë, posesivë dhe pretendonin vëmendje ekskluzive. Më e keqja ishte se shpesh nuk donin të iknin më.

- Një javë më parë, krejt papritur, Eva më kërkoi t'ia dëboja shokun pasi nuk donte të luante më.

Pa shiko, tha me vete.

- Nuk ia dola, - pranoi vajza gati me turp. - Ai është akoma.

- Që nga ai çast, gjërat kanë marrë tatëpjetën, - hamendësoi Xherberi dhe i përshkroi çfarë duhej të kishte ndodhur. - Eva ka filluar të vritet vetë e ia hedh fajin shokut.

Të nxira dhe gërvishtje sidomos te këmbët dhe krahët.

Maja Salo zgurdulloi sytë e gjelbër dhe përkuli kokën majtas me mosbesim. - Vetëm të nxira, - e ndreqi. - Po ju nga e dini?

- A ta ka përshkruar ndonjëherë atë fëmijën tjetër? - vazhdoi Xherberi, pa iu përgjigjur pyetjes.

Vajza dukej gjithnjë e më e pështjelluar. U përpoq të kujtonte. - Jo, - tha më pas.

- Dhe vë bast se shoku imagjinar nuk ka emër.

- Eva refuzon të tregojë si quhet, - pohoi ajo me atë tonin e bezdisur të atij që nuk arrin të kuptojë.

Xherberi nuk donte t'i tregonte që sapo kishte përshkruar sinjalet e para të skizofrenisë infantile. Nga sa dukej, Eva kishte filluar shumë shpejt të dëgjonte zëra imagjinarë

Pa kurat e duhura dhe në kohë, shfaqjet sporadike të patologjisë do të degjeneronin në një shkëputje të plotë nga realiteti. Dëmtimet e vetëshkaktuara tregonin se fëmija kishte filluar të hynte në konflikt me personalitetin e dytë që gjendej brenda saj. Pa mjekimet e përshtatshme dhe duke u rritur, do t'i shfaqeshin edhe shokë të tjerë imagjinarë, shumë më të rrezikshëm për të dhe për personat rreth saj.

Hipnotizuesi i fëmijëve u mjaftua duke thënë:

- Eva nuk ka nevojë për hipnotizues, por për psikiatër.

Fjala e fundit pati një efekt i cili e shkundi Maja Salon në thellësi.

Duke parë drithërimën e buzëve mishtore dhe të lotëve që nisnin t'i njomnin sytë e gjelbër, Xherberi thuajse u pendua që u tregua aq i drejtpërdrejtë. Një reagim të tillë nuk e priste, por në fund të fundit, nuk kishte pasur zgjedhje tjetër.

Vajza ia dha të qarit. Duke qenë se nuk dinte si ta ngushëllonte, ai qëndroi në heshtje.

- Kam frikë se mund të ndodhë ndonjë gjë e shëmtuar dhe jam e sigurt që edhe Eva është tmerruar, - tha ajo mes ngashërimeve. Më pas e vështroi me ashpërsi. - A e dini çfarë do të thotë të jesh fëmijë dhe të kesh frikë nga vdekja, zoti Xherber?

Kur isha njëmbëdhjetë vjeç kam rënë nga një ballkon dhe zemra më ndaloi për tridhjetë sekonda, deshi t'i thoshte Pjetri për ta ngushëlluar. Por nuk ekzistonte asnjë motiv i pranueshëm për të ndarë një episod kaq intim me një të panjohur. A ndoshta po. Maja Salos i kishte mbetur një tufë flokësh ngjitur në fytyrë dhe atij i erdhi një dëshirë e madhe t'ia zhvendoste.

- Më vjen keq, por jam tmerrësisht vonë për diku, - i tha duke e dëbuar atë mendim dhe duke i lënë të kuptonte se i kishte kushtuar kohë më shumë nga sa duhej. Por tani kishte ardhur çasti që të nisej për te takimi në Kafe Paskovski.

Burri me orë xhepi po e priste.

Maja nuk lëvizi vendit. Fshiu fytyrën me kurrizin e pëllëmbës së dorës si vogëlushe. Më pas rrëmoi në xhepat e palltos nga ku nxori një letër të vogël e të vulosur me kujdes. Ia dha.

- Kur i thashë Evës se do të vija te njeriu që e quajnë Gjurmëvënësi i fëmijëve, më dha këtë.

Xherberi i nguli sytë letrës në dorën e tendosur që Maja Salo përpiquej të mos i dridhej.

- Është për ju zoti Xherber. Por nuk di çfarë ka shkruar dhe Eva nuk deshi të ma thoshte.

Ai nuk kishte aspak ndër mend ta merrte dhe, nga mënyra se si ishte zhubrosur zarfi e mori me mend se kushedi prej sa kohësh duhet t'i ndodhej në xhep. Dhe se për këtë arsye, gënjente. Mesazhi i Evës nuk i ishte drejtuar atij. - Sa prej kolegëve të mi psikologë fëmijësh jua kanë refuzuar rastin?

Vajza uli dorën ku mbante letrën e mandej edhe vështtrimin:

- Ju jeni i fundit që keni mbetur.

I binte të ndihej i fyer. Por, kohët e fundit, nisur nga rrënimi i reputacionit të tij, Pjetri Xherberit i shkoi përnjëherë në mendje se ai nuk duhej të kishte qenë zgjedhja e parë. Megjithatë, nuk donte të përfaqësonte as shpresën e fundit për një pacient. E kapi një dhembshuri e madhe për Maja Salon, pasi dukej qartë se e kishte shumë për zemër vogëlushen, për të cilën përkujdesej, ndonëse nuk ishte fis me të dhe e njihte prej vetëm pak muajsh. Por kjo për fat të keq nuk i ndryshonte gjërat.

- Keq më vjen, por nuk mund ta marr përsipër.

Palltoja e vjetër *Barberi*, e cila një kohë kishte qenë e zotit B. ishte një aleat i përsosur në atë mbrëmje fundshkurti me erë. Prej këpucëve *Klarks* të murrme e me shollat e ngrëna, rrezikonte të rrëshqiste në çdo hap që hidhte mbi pllakat e lagura të trotuarit. Shi nuk binte, por ajri ishte i mbarsur me lagështi. Nën shtyllat e dritave rridhte një mjegull e portokalltë. Si një lumë fantazmë, pallatet e qendrës vë vjetër i shërbenin si pritë.

Në mbulojën që i errësonte pamjen, Kafe Paskovski, me dritat vezulluese dhe me notat e një muzike të lehtë”. Pjetër Xherberit iu duk si një liman i sigurt dhe i rehatshëm.

Kaloi mes për mes sheshit Republika, tashmë bosh dhe u fut në lokalin e vjetër të stilit *déco*.

Te hyrja, kamerierët dhe personeli me uniformë të rreshtuar te banaku prej lisi dhe bronzi u kthyen drejt tij për ta pritur. Buzëqeshja iu shua nga pamja e tij të lëshuar.

Të pranishëm, ishin disa myshteri, të cilët njëllonj si ai, kishin gjetur strehim tek aromat e pijeve të vjetra alkoolike

dhe muzikës klasike. E shpërfillën dhe vazhduan të bisedonin duke gjerbur kokteje me baze vermu në gota kristali dhe duke dëgjuar një kuartet harqesh që po luante “Dimrin” e Vivaldit.

Xherberi përfitoi nga fakti që nuk ra në sy, për t’ kredhur në atë atmosferë pezull në kohë dhe eci sipër mozaikut me pllaka të vogla bardhë e zi drejt e për në sallën me tavane të larta dhe llambadarë të bardhë gjysmësferikë, të ngjashme me bebëza të mëdha sysh.

Vazhdoi mes tavolinave dhe ndaloi përpara njërës ku rrinte një qostek floriri në formë qepe, me një zinxhir i cili përfundonte në dorën e një zotëri shtatëdhjetëvjeçar, që përtypte një puro të shuar me aromë anasoni.

- Mirëmbërma zotëri, - e përshëndeti, sado që nuk ishin parë kurrë.

- Ju lutem, - ia bëri tjetri duke e ftuar të ulej dhe duke i treguar me dorë vendin e lirë përpara vetes.

Burri tërhoqi orën nga tryeza dhe e futi në xhep. Xherberi hoqi pardsynë e lagur, e mbështeti te shpinorja e kolltukut dhe më pas u ul. Po mardhte.

- Kalindri, - u prezantua tjetri vetëm me mbiemër. - Do merrni diçka? - e pyeti duke ngritur menjëherë krahun për t’i bërë shenjë ndonjërit prej kamerierëve. Për vete po pinte një koktej Negroni.

- Jo, faleminderit, - ia ktheu psikologu.

Tjetri ndali.

- Si të doni.

Pas një pasditeje ku kishte analizuar mendjen e rrezikshme të Tomit të vogël dhe pas takimit të trishtuar me vajzën finlandeze dhe rrëfimit të saj mbi Evën dhe shokun

imagjinat, Xherberi donte vetëm të mbaronte punë një orë e më parë e të kthehej në shtëpi.

- Siç ju tregova me telefon, zoti Kalindri, numrin tuaj ma kanë dhënë disa të njohur, të cilët punojnë në Gjykatën e të miturve. - Psikologu i fëmijëve kishte ende kontakte në atë institucion ku nuk punonte më.

- Dhe çfarë ju kanë thënë konkretisht për mua?

- Se në të kaluarën keni punuar në forcat e rendit, se jeni tepër i rezervuar dhe se nuk keni zyrë, - përfundoi duke treguar rrotull.

Tjetri vuri buzën në gaz.

- Le të themi se parapëlqej që punët t'i kem gjithnjë ... në lëvizje.

- Përgëzime! Jeni treguar shumë i zoti që jeta juaj të mos bjerë në sy.

- Ky është rregulli i parë i zanatit.

- Po ju çfarë dini për mua? - e vuri në provë Xherberi. - Them se duhet të keni marrë informacione përpara se të më takonit.

- Jeni i divorcuar. Silvia, ish-gruaja juaj, jeton në Livorno bashkë me Markon, djalin tuaj dhe po martohet përsëri.

Sado që ato detaje të pakta personale i dinte edhe vetë, t'i dëgjonte aty i shkaktoi gjithsesi një sëmbim. Një dhimbje e pashpjegueshme klinike, të cilën vetëm baballarët e ndarë mund ta provojnë.

Kalindri vazhdoi:

- Keni trashëguar profesionin e babait tuaj vdekur shtatë vjet më parë. Në moshën dy vjeçe keni humbur nënën.

- Janë të dhëna publike, - tha Xherberi sikur donte të vinte në pah që gjetja e tyre që nuk ishte edhe aq e vështirë.

Tjetri, pa i lëvizur qerpiku, hoqi puron nga goja dhe gjerbi Negronin. Më pas vendosi sërish gotën mbi tryezë.

- Nuk pranoj shumë klientë, - saktësoi. - Punoj gjithnjë me të njëjtët persona, më së shumti kompani apo studio ligjore. - Dukej se kërkonte një justifikim për të refuzuar detyrën. - Në telefon më zutë në gojë idenë e një gjurmimi. Është punë delikate dhe kërkon zhvendosje të shumta. Nga përvoja e di se kush kërkon një shërbim të tillë, zakonisht pret rezultate thuajse të menjëhershme. Ja përse preferoj t'ju paralajmëroj se kush nuk ka shumë kohë në dispozicion dhe para për të paguar, më mirë të mos e nisë fare.

- Nuk do të ankojem në rast se do të dështonit, - i premtoi psikologu. - E di se keni pranuar të më takoni pasi ju kanë thënë që jam njeri i duruar. Por me siguri duhet ta keni marrë me mend se po ju drejtohem juve pasi nuk kam zgjedhje tjetër.

Burri e zhibroi, ndoshta po përpiquej të analizonte, a ndoshta edhe të kuptonte nëse duhej t'i besonte. - E kë duhet të ndjek kështu? - e pyeti.

- Mua.

Përgjigja e shpejtë e Xherberit e hutoi.

- Juve? - pohoi për të vënë në pah habinë.

- Saktë, - gjegji tjetri. - Nuk është nevoja të më rrini gjithë kohën pas. - Do ju bëj të ditur vendet që frekuentoj zakonisht dhe do të biem dakord rast pas rasti. Mund të më mbikëqyrni duke filluar nga studioja ime

- Është e pazakontë si detyrë, - komentoi Kalindri pa e dhënë shumë veten.

Por shprehja hezituese e fytyrës lypte një shpjegim të përshtatshëm.

- Rreth dy vjet më parë kam pasur në terapi një grua, - i tha psikologu.

- A nuk ju quajnë ai që ve në gjumë fëmijët? - ia ktheu menjëherë detektivi.

- Po, ashtu është, - konfirmoi Pjetri. - Ka qenë hera e parë dhe e fundit që i kam bërë terapi një të rritur.

- Dhe si ka mundësi që e pranuat rastin?

- Për të ndihmuar fëmijën që gjendej brenda saj, - u përpoq ta thjeshtëzonte Xherberi, por realiteti pati qenë shumë më i ndërlikuar. - Ajo vajzë, robinjë e mendjes së saj, komunikonte vetëm nëpërmjet hipnozës.

- Quhet Hana Holl. - Zakonisht ai emër i endej në mendime, por në atë çast, Xherberi zbuloi se duke e shqiptuar me zë të lartë i shkaktonte droje, sikur sapo të kishte thënë ndonjë gjë të ndaluar. U mundua ta hiqte këtë ndjesi. - Hana kishte ardhur në Firence nga Australia për të hetuar në lidhje me një ngjarje të fëmijërisë së saj. Nga ana ime, kisha bindjen se do të arrija ta mbaja nën kontroll terapinë, por më doli pa e kuptuar nga dora... Diçka që nuk duhet të ndodhë kurrë, veçanërisht në profesionin tim.

- Edhe në timin është tepër e rrezikshme, - vërejti Kalindri.

- Rolet mes meje dhe Hanës u këmbyen, - vazhdoi ai. - Papritmas, erdhi puna që ajo po më analizonte mua.

Tjetri ngriti njërën vetull, ndoshta duke vrarë mendjen se si mund të ndodhte diçka e tillë.

- Problemi është se pacientja u zhduk përpara se të mbaronte procesi i terapisë. - Dhe mori me vete edhe tërë ato të fshehta, mendoi Xherberi pa e shprehur

- Më falni, zotëri, por ç'lidhje ka tërë kjo me gjurmimin që unë duhet t'ju bëj juve?

Xherberi mori frymë thellë.

- Hana Hollin e shoh gjithë kohës, - pohoi. - Në reflektimin e një vitrine. Në një grup turistësh që kalojnë rrugën. Kalimthi në mes të një turme. - Vrojtimit e para kishin përkuar me shembjen psikike të tij për shkak të Trilluesit magjepsës. - Nuk arrij kurrë ta vatërzoj në kohë dhe mirë fytyrën dhe mbeten gjithë kohës me dyshimin se mund të jetë vetëm ndonjë shaka e mendjes, ndonjë si punë halucinacioni. - Uli vështrimin në siklet.

- Kështu, unë duhet t'ju ndjek për të zbuluar nëse kjo Hana Holli ekziston vërtet apo nëse është fryt i përfytyrimit tuaj.

Xherberi pohoi me kokë. Kishte marrë vendimin të pajtonte një detektiv privat, i cili të rrekej t'ia vinte në vijë jetën. Në fund të kësaj, ndoshta, pacientët do t'i riktheheshin e pse jo mund të rifillonte edhe jetën e dikurshme. Zoti B. thoshte gjithmonë se të pranosh që ke një problem është hapi i parë për ta zgjidhur. Por e vërteta ishte se burri që tani ishte ulur përballë tij, përbënte mundësinë e fundit për të mësuar nëse ishte a jo duke u çmendur.

- Jo, - e frenoi përnjëherë Xherberi i alarmuar. - Unë nuk dua t'ia di nëse ndodhet këtu në qytet dhe as ku banon. - Vetëm ideja e kësaj ishte e papranueshme për të, pasi do të thoshte se dëshironte ta gjente. - Dua vetëm të zbuloj nëse është kjo është thjesht një obsesion imi. Dhe nëse do që t'i shërosh obsesionet, nuk duhet kurrë t'u shkosh pas.

Nuk shtoi që pacientja zotëronte informacione në lidhje me të kaluarën e tij dhe se nuk ishte i sigurt nëse donte të

fillonte nga e para me gjëra tanimë të varrosura. Po ashtu, nuk dëshironte t'i thoshte as edhe se, me gjasa, ndiente diçka për Hana Hollin. Diçka ndryshe nga ai proces i transfertës së zakonshme pacient-klient. As edhe ndonjë nga ato dallditë e ndjenjave, të cila shuhet vetvetiu me kalimin e kohës.

Një tërheqje e pashëndetshme.

Mënyra e vetme për të kufizuar efektet e kësaj ishte të qëndronin larg. Vetëm kështu ai dhe Hana nuk do t'i bënin keq njëri-tjetrit.

- A keni ndonjë foto të kësaj gruaje? - e pyeti detektivi privat.

- Për fat të keq jo, - u përgjigj Xherberi. - Ndoshta prandaj e shoh ngado. Mundem vetëm t'ua përshkruaj: tridhjetë e dy vjeçe, bionde, sy të kaltër, flokët më së shumti bisht dhe vishet gjithnjë me të zeza.

Nuk është as e bukur ndërmendi. Është magjepsëse dhe e rrezikshme. Dhe dy gjërat ishin të lidhura ngushtësisht.

- Kur e njihja pinte duhan. Por nuk jam në gjendje të them nëse ishte një ves i mirëfilltë apo një tik i personazhit që luante një rol të caktuar kundrejt meje. - *Dhe kështu është vërtet, mendoj, unë nuk e di kush është Hana Holli.*

- Kaq është e gjitha? - u mrekullua tjetri. - Me kaq pak detaje do ta kem të vështirë, - e paralajmëroi.

- Ju duhet vetëm të më thoni nëse një figurë e ngjashme me atë që sapo përshkrova do të sillet rrotull nëpër vendet që frekuentoj unë zakonisht. Kaq më mjafton, nuk kërkoj tjetër, - nguli këmbë. - Më duhet një vrojtues i vëmendshëm a ndoshta një dëshmitar i mirë. Rolin zgjidheni ju. Me një fjalë, kam nevojë për dikë që të më thotë se nuk kam luajtur krejt nga mendja.

- Dhe më pas nuk do të doni të mësoni gjë tjetër? - pyeti për t'u mbrojtur Kalindri. - A jeni plotësisht i sigurt se nuk do të më kërkonti ku banon Hana Holli apo si të viheni në kontakt me të? Sepse, në një rast të tillë duhet t'i kem qysh tani të qarta qëllimet tuaja, zoti Xherber. Nëse ju, për shembull, ushqeni ndonjë mëri kundrejt asaj gruaje apo nëse ekzistojnë arsye të tjera, për të cilat kërkonti shërbimet e mia, atëherë e kam për detyrë t'ju njoftoj se nuk do të jem i detyruar t'jua plotësoj pretendimet që do të shfaqni. Kam pasur të bëj me shumë P.P.

- Me çfarë? - pyeti Xherberi i habitur.

- Persekutues paranojakë, - e sqaroi Kalindri, duke shpjeguar geramat nistore.

- Unë nuk jam paranojak dhe aq më pak persekutues, - e garantoj Xherberi. Për hir të së vërtetës ky përcaktim do i shkonte më shumë për shtat Hanës. Duke e konsideruar të përfunduar takimin, u ngrit dhe mori pallton ende të lagur nga shpinorja e karriges. - Edhe diçka të fundit, - tha përpara se të largohej. - Këtë Hanën, mos e nënvlerësoni kurrë.

Kalindri futi në gojë puron me shije anasoni.

- Nuk besoj se do të ketë probleme në këtë drejtim, - iu përgjigj besimplotë.

Ashtu qoftë, tha me vete e me një fije keqardhje Pjetri. *Kështu mendoja edhe unë*. Dhe e kuptoi përse ishte druajtur nga Maja Salo.

Kam frikë se mund të ndodhë ndonjë gjë e shëmtuar dhe jam e sigurt që edhe Eva është tmerruar.

Ora ishte gati nëntëmbëdhjetë e tridhjetë kur Pjetër Xherberi po e bënte me këmbë rrugën për në shtëpi, pa mundur t'i hiqte dot nga mendja fjalët e vajzës me flokë të kuqe. Tani e kuptonte se ndoshta ishte treguar shumë i ashpër me të për shkak të takimit me atë personin me qostek.

Por mbi të gjitha për shkak të Hana Hollit.

Maja Salo ishte paraqitur në studio pa kërkuar takim më parë dhe më e rënda, ishte futur deri në brendësi të papafingos pa leje, duke mbërritur aty ku zakonisht të rriturve nuk u lejohej, duke u shtyrë deri te dera e dhomës së zotit B., madje.

Mes sallës së pritjes dhe korridorit ekzistonte një kufi tepër i përcaktuar, i cili vetëm fëmijëve u lejohej ta kapërcenin.

Fëmijëve dhe Hana Hollit, ndreqi veten Xherberi, duke ndërmendur seancat me atë krijesë të çuditshme, e cila

pinte cigare njëra pas tjetrës në të njëjtin vend ku, për arsye të njohura, të tjerëve kjo nuk u ishte lejuar. Disa liri të caktuara ai ia kishte dhënë vetëm Hanës. Dhe tani nuk donte ta përsëriste më gabimin.

Por skrupujt në lidhje me atë që kishte ndodhur atë pasdite e përndiqnin. Mëtoi të shpejtonte hapin sikur kjo për ndonjë arsye të pakuptimtë kjo t'i jepte mundësinë t'i largohej me të shpejtë mendimit të vajzës me flokë të kuqe, e cila thuajse i ishte përgjëruar për ndihmë. Por, kur bënte kohë e keqe, këmba që kishte thyer në fëmijëri, ia ngadalësonte gjithmonë paksa hapin.

A e dini çfarë do të thotë të jesh fëmijë e të kesh frikë nga vdekja, zotëri?

Akoma nuk i besohej që kish shkuar deri në pikën ku për pak sa nuk i tregoi Majës, një person krejt i panjohur për të, kujtimet e tij më të brendshme e më të hidhura të atyre tridhjetë sekonda kur vdiq.

Pak a shumë, në fund të periudhës së adoleshencës, Pjetër Xherberi, kur ndokush e pyeste sa vjeç ishte, me mendje, e zbriste gjithmonë nga mosha atë gjysmë minute. E vërteta ishte se duke u rritur, kishte ndier nevojën për ta fshirë nga kujtesa verën e 1997-ës. Jo për shkak të aksidentit në ballkon, por për atë të lojës së dyllosjes që e kishte ndjekur si spektator disa javë më pas e kur Xeno Xanusi, i quajtur Batigol ishte zhdukur në hiç mu përpara syve të tij.

Sa më tepër koha largohej nga Xeno, aq më tepër Xherberi ndihej i autorizuar ta harronte. Dhe, pasi u bë baba, fshirja e asaj ndodhie u kthye gati në një domosdoshmëri, e cila ia preu ndërpreu si me thikë fëmijërinë. Edhe vetëm ideja që diçka e tillë mund t'i ndodhte Markos ishte e

papërballueshme. Ndoshta, për këtë arsye nuk e kishte çuar kurrë të birin për verim në Porto Erkole. Donte ta mbante sa larg që të ishte e mundur nga një ide.

Errësira i merrte njerëzit.

Ky kishte qenë zbulimi më tronditës i fëmijërisë së tij.

Pjetri dhe shokët e tij të vegjël zbaviteshin me lojën e dyllosjes pasi nuk e kapnin domethënien mizore të saj: kush prekej, humbiste përgjithmonë të drejtën për të folur e, si rrjedhojë edhe për të ekzistuar.

Ndërkohë, Arimo, i deklaruar nga i mbijetuari i vetëm, do t'i vinte gjërat në rregull duke i kthyer të gjithë nga bota e territ.

Por fakti që Zeno Xanusi nuk e kishte shqiptuar kurrë atë fjalë të mistershme çliruese, u tregoi të gjithëve një realitet të trishtë. Se terri ekziston vërtet dhe se ka disa tipare të caktuara. Njëlloj si zhgënjimi përvëlues kur zbulon se nuk ka asnjë Babagjysh Krishtlindjeje. Dhe, para së gjithash, që nuk ka asnjë Perëndi që të pengojë zhdukjen e një fëmije pesë vjeç.

Deri atë të diel të mallkuar korriku, Pjetri Xherberi nuk kishte dyshuar për peshën që kishte në ekzistencën e të rriturve takimi i pashmangshëm me errësirën. E megjithatë duhej ta bënte. Terri i kishte marrë nënën. Me siguri zoti B. do të kishte dashur të mësonte çfarë enigme fshihej në ato tridhjetë sekondat kur zemra e djalit të tij të vetëm kishte ndalur.

Por i ati nuk e mori kurrë guximin ta pyeste çfarë kishte gjetur te terri.

Pjetri, ama, e dinte çfarë i kishte ndodhur Xenos dhe kjo e fshehtë e bënte të ndihej tmerrësisht në faj. Për këtë

arsye nuk ia kishte rrëfyer kurrë askujt. Zhdukja e shokut të vogël, ishte varur vetëm prej tij. Ai ishte përgjegjës, pasi disa javë përpara se Batigoli i vogël të zhdukej, atë vetë, e keqja e kishte kursyer.

Në vend të tij terri kishte marrë Xenon.

Edhe tani në moshën tridhjetë e pesëvjeçare, Pjetër Xherberi nuk arrinte ta hiqte nga supet barrën e idesë absurde se kishte luajtur një rol të pavetëdijshëm në fatin e shokut të gjorë të lodrave.

Quid pro quo.

Xeno Xanusi, me siguri kishte vdekur. Edhe pse askush nuk kishte marrë guximin ta deklaronte haptazi.

Pas vitesh të tëra, psikologu përpëlitej ende në ato përsiatje. Dhe teksa po shkonte drejt shtëpisë së tij, duke sfiduar një mbrëmje dimri shtërënguar brenda palltos me vështrimin poshtë dhe pamjen e shprishur të njeriut që i vërtiten me mijëra mendime në kokë, i qëlloi të kalonte përsëri poshtë studios. Ngadalësoi hapin, pasi në ajrin e rralluar, mes vrundullit të mjegullës, iu duk se dalloj një trajtë njerëzore të njohur, ndalur te streha e autobusëve publikë.

Edhe ajo e njohu.

- Humba autobusin e fundit dhe nuk di si të kthehem në shtëpi, - tha Maja Salo, sikur donte të justifikohet para tij. Duart brenda xhepave të palltos *Montgomeri*. Kallkan e tëra. Buzët vjollcë.

- Ejani, gjejmë ndonjë vend, të pini diçka që t'ju ngrohë, - e ftoi Xherberi. - Më pas ju thërras një taksi.

- Nuk kam mundësi për taksi deri në San Xhiminjano, - e tha haptas ajo, duke ulur vështrimin për një çast.

- Për këtë mos e vrisni mendjen, e paguaj unë.

Vajza shqeu sytë e gjelbër dhe përkuli kokën në të majtë, siç Xherberi e kishte parë ta bënte edhe më parë. Ndonëse e njihte prej pak kohësh, e kishte kuptuar se ky ishte reagim tipik i saj. Kushedi sa herë e përsëriste të njëjtin gjest pa e kuptuar as ajo vetë. Me siguri, ata që kishin fatin të rrinin pranë saj do ta kishin vënë re. Njëlloj si dhe vetë që kur u martua me Silvian kishte pasur privilegjin të shihte rrudhën e vogël që i formohej te balli sa herë ai i afrohej për ta puthur.

- Kam hallin se Eva është vetëm, - tha Maja.

Kjo e habiti.

- Si vetëm?

- I kërkova guvernantes që të rrinte me të deri sa të kthehesha unë, por tani është bërë vonë.

- Dhe ku është problemi?

- Puna është më e ndërlikuar nga sa duket, - u përpoq të shpjegonte me droje vajza.

- Nuk e kuptoj, guvernantja nuk banon me ju?

- Zonja Vanini ikën përpara se të perëndojë dielli.

- Dhe nuk ka asnjë tjetër në shtëpi? - Xherberi mendonte për ndonjë roje a personel shërbimi.

Maja tundi kokën.

Psikologu përsëri e kishte të pamundur të përfytyronte një vajzë të re dhe një vogëlushe në një shtëpi të veçuar në mes të fushave e sidomos natën.

Tjetra uli sërish vështrimin , ndoshta për të fshehur sikletin ngaqë duhej të pranonte se nuk ndihej e sigurt.

- Shtëpia është shumë e lashtë dhe e madhe, por ne banojmë vetëm në njërën pjesë.

Qysh kur e shoqja dhe i biri ishin transferuar në Livorno pas divorcit, Pjetër Xherberi jetonte i vetëm në një apartament të stërmadh dhe e dine mirë ç'do të thotë të ndiheshë i cënueshëm dhe natë për natë të bije për të fjetur pa pasur dikë pranë. Pikërisht për këtë arsye, vrau mendjen se si mundej ajo vajzë të merrte përsipër përgjegjësi të tillë.

- Po të kemi nevojë, zonja Vanini vjen përnjëherë, - u përpoq ta qetësonte Maja. - Nga fshati deri te vila dhe shtëpia duhen vetëm dy minuta.

Dukej qartazi se përpiquej të bindte para së gjithash veten. Por gjendja nuk ishte aspak normale. Ç'dreq njerëzish ishin këta Oneli Katalanit? Si mund të lejonin që një vajzë dhjetë vjeçe të jetonte në mes të askundit me një të panjohur? Vrau mendjen. Mori celularin nga xhepin i palltos *Barberi* për të thërritur një taksì.

- Tetë minuta, - i tha vajzës sapo një zëri i regjistruar i komunikoi për sa kohë do të mbërrinte taksia. Xherberi shpresonte të nevojitej më pak, ngaqë druhej mos tjetra do t'i kërkonte përsëri të merrte përsipër rastin e Evës.

Maja Salo bëri një hap drejt tij teksa drita e llambës nga shtylla i binte mbi flokët e kuq duke i formuar bashkë me lagështinë një brerore të shkëlqyeshme rreth fytyrës. - Zoti Xherber, sipas jush a mund të ketë shkak tjetër veç skizofrenisë?

- Sigurisht nuk përjashtohet që Eva ta ketë sajuar shokun imagjinar pasi ka nevojë të dëshpëruar të rrijë me fëmijët e tjerë.

- Nuk e kisha fjalën për këtë, - tha vajza duke mos ia hequr sytë.

Atëherë ku po e hidhte bisedën? Për çfarë t'i mbushte mendjen? Se ekzistonte ndonjë shpjegim tjetër?

- Sido që të jetë, ai fëmijë imagjinar e pa emër, tani po ngrihet kundër saj, - shtoi Maja Salo, me një rreptësi të papritur. - Tërë kjo, a nuk ju përçon një ndjesi frustrimi, zoti Xherber? Eva i bën keq vetes pasi nuk ka zgjedhje tjetër.

Taksia mbërriti më përpara, duke e shpëtuar Xherberin nga pozita e sikletshme ku duhej t'i jepte një përgjigje. U largua nga Maja dhe shkoi te taksisti për të diskutuar çmimin deri në San Xhiminjano. Më pas hapi derën e pasme dhe e ftoi të hipte.

- Për dyzet minuta duhet të mbërrijë te shtëpia, - i tha.

Maja ia shmangu vështirimin. - Faleminderit, nesër do të gjej mënyrën t'ju kthej paratë.

- Dëbimi i miqve imagjinarë nuk është specialiteti im, - pohoi, duke u mbështetur te dera ende e hapur. - Por nesër do të vij te ju për t'i hedhur një sy Evës.

Vajza u duk e gëzuar nga kjo kthesë e papritur, por aty për aty u err.

- Duhet t'ju paralajmëroj për diçka, - tha. - Shokut imagjinar nuk i pëlqejnë risitë dhe po s'ia pati ënda ndonjë gjë, më pas ia nxjerr Evës dhe unë e gjej me të nxira të tjera nëpër trup.

Do të ishte e ndërlikuar, mendoi psikologu, por e qetësoi.

- Në fund të fundit, edhe ai fëmijë është, - tha me buzën në gaz. - Dhe fëmijët janë specialiteti im.

Përpara se të nisej taksia, ranë dakord të shiheshin te nesërmen pasdite.

Maja rrëmoi në xhepat e *Montgomerit* blu dhe nxori letrën e Evës, të cilën ishte përpjekur t'i dorëzonte pak

orë më parë, kur po dilte nga studioja. - Ndonëse nuk e ka shkruar enkas për ju, zoti Xherber, mendoj se e ka fituar të drejtën të dihet çfarë përmban.

Xherberi e harroi gënjeshtren, me të cilën Maja ishte përpjekur ta bindte dhe mori zarfin e zhubrosur. Vështroi taksinë që po largohej, me shpresën se kishte bërë zgjedhjen e duhur. Përpara se të nisej sërish drejt shtëpisë, vendosi të hapte zarfin. Priste ndonjë vizatim a ndonjë frazë të butë me gabime gramatikore dhe s'do mend që nuk ishte hera e parë që kishte të bënte me letra të kësaj natyre.

Te fleta ishte shkruar vetëm një fjalë, Duke e lexuar iu duk sikur diçka e tërhoqi dhe thithi pas në kohë. Po e priste prej njëzet e pesë vjetësh.

Arimo.

6

Ajo fjalë e gozhdonte si një akuzë e rëndë. Një tregues i vogël që ishte drejtuar për nga ai. Gishti i një fëmije pesë vjeç.

Kjo koincidencë e pakuptimtë ia hoqi gjumin Pjetër Xherberit dhe për gati gjithë natën rrotullua në shtrat. Sado që me mendje refuzonte çdo lidhje të mundshme me ngjarjen dramatike të kohës kur kishte qenë njëmbëdhjetë vjeç, kundërgoditja emocionale filloi nga puna. Ndjesitë e përjetuara në verën e vitit 1997, kur bashkë me shkujdesjen dhe pafajësinë i përfundoi para kohe edhe fëmijëria, u bënë të gjalla.

Për gjithë pjesën tjetër të ditës, mendja e tij vazhdoi të kthehej te lidhja e çmendur mes pusullës dhe të kaluarës së tij. Edhe sikur të mos kishte pasur tërë atë kohë të lirë e ndonjë pacient për t'u marrë, gjithsesi do ta kishte pasur të pamundur të përqendrohej. Në kokë i sillej vetëm Ishoja, Debora, Eto, Karletoja, Xhovanone, Dante. Banda e Porto

Erkoles me një fjalë. Me përjashtim të Ishos, kushëririt, me të tjerët Xherberi i kishte humbur kontaktet prej shumë kohësh. Nga të ishin vallë?

Si ishin rritur në jetë me peshën e çfarë mund t'i kishte ndodhur Xenos? Para së gjithash, a e mendonin ende apo e kishin shtyrë nga kujtesa atë që kishte ndodhur? Në rast se kishin arritur ta harronin, si kishte ndikuar ajo ngjarje në jetën e tyre?

Përveç ditëve me mot të lagësht kur ndiente një bezdi të lehtë nga këmba e thyer në atë kohë, Pjetri nuk kishte arsye të mendonte për Batigolin e vogël. Kështu, Xeno Xanusin e kishte ngjeshur në një cep të largët të kujtesës. Dhe kishte qëllim ta linte atje deri sa të vinte edhe ora e tij a ndoshta në prag të vdekjes, do t'i bënte llogaritë me brerjet e ndërgjegjes.

Po ja që Maja Salo dhe një vajzë dhjetë vjeçe po e detyronin ta afronte atë çast.

Sipas jush a mund të ketë ndonjë arsye tjetër përveç skizofrenisë?

Jo, nuk kishte.

Prandaj, aty nga ora tre e asaj pasditeje dimri, Pjetër Xherberi i hipi fuoristradës *Defender* te vjetër, të cilën zoti B. e kishte mbajtur me kujdes dhe tani gjendej rrugës për në San Xhiminjano. Ndërkohë që kalonte fushat e Kiantit, duke u këndellur në peizazhin kodrinor, ai reflektonte mbi atë shaka rasti që i kishte punuar, dhe ai kishte rënë viktimë. Ndihej edhe paksa budalla: mos duhej ta kishte lënë atë punë e të mos merrej fare me të?

Por sado që të përpiquej nuk ia dilte dot.

Eva letrën nuk e kishte shkruar për të dhe Maja ua kishte treguar të gjithë terapeutëve ku kishte shkuar. Fakti është se të gjithë kishin refuzuar ta merrnin përsipër atë rast. Një dredhi e pafajshme për t'i bindur, por të cilën asnjëri nuk e kishte “ngrënë”. *As unë*, tha me vete psikologu. Por sa mundësi kishte që mesazhi në atë fletë të lidhej aq privatisht me të? Sigurisht edhe kjo mund të ishte krejt rastësore.

Në raste të tilla. Gustav Jungu fliste për “sinkronicitet”

“Ditën kur ti vendos të fillosh dietën do të gjendet gjithmonë dikush që të dhuron një kuti me çokollata”, thoshte gjithmonë zoti B. “Jeta është plot me kthesa të fatit, por ne i vëmë re vetëm atëherë; kur jemi të detyruar t'u kushtojmë vëmendje.”

I ati dhe Jungu kishin të drejtë, por këtë parim e kishin kuptuar edhe plot fallxhorë e mashtrues, të prej kohësh e shfrytëzonin sa më shumë në dëm të fatzinjve të parrahur me jetën.

Arsyetimi i Pjetri Xherberit qëndronte dhe kjo e bëri të lehtësohej, por pa vonuar logjika do t'i përplasej sërish me diçka, e cila nuk e bindte.

Arimo.

Hipnotizuesi vriste mendjen se si një fjalë anakronike, me aq sa dinte ai, e tashmë e zhdukur nga zhargoni i fëmijëve të vegjël, kishte arritur të futej tinëzisht në fjalorin e një vajze dhjetë vjeçe, lindur në mijëvjeçarin e ri.

Këtu kishte diçka të çuditshme. Gjithë rrugës thoshte me vete që këtë po e bënte për të ndihmuar Evën. Në të vërtetë, e bënte edhe për të takuar shokun imagjinar të asaj vogëlusheje.

Shtëpia e madhe e bardhë ngrihej mes dy kodrave të buta, në mes të ullinjve dhe vreshtave. E rrethuar nga qiparisa hijerëndë dhe të ngrefosur si roje mbretërore, ajo shtëpi shquhej nga disa kilometra largësi.

Tokat e Oneli Katelanëve shtriheshin me disa hektarë dhe ndaheshin më dysh nga një shteg i paasfaltuar. Idenë e hapësirës së madhe që zinte ajo pasuri, Xherberi i krijoi duke llogaritur kohën që iu desh fuoristradës për të mbërritur te rezidenca e fundit të 1700-s.

Teksa dielli sapo kishte nisur zbritjen në horizont, fuoristrada kaloi një portë të madhe me kangjella të zeza dhe pak më pas ndaloi te një shesh ku u krijua një re pluhuri, përballë një shatërvani me gurë të kaltër. Nga grykat e tij nuk dilte ujë dhe në vaskë ishte krijuar një llum i gjelbëremë.

Xherberi zbriti nga makina dhe futi dy gishta te jaka e golfit që e mbante nën pallto, pasi kur i fërkohej me mjekrën e ashpër i shkaktonte një kruarje të lehtë. Në të vërtetë, gjithçka e bezdiste dhe ishte nervoz. Ndërkohë vështronte rreth e rrotull.

Vendi ishte i bukur, por i shkretë.

Suvaja kishte rënë në disa vende. Barërat e këqij dilyn nga toka dhe gëmushat kishin nevojë për një vadtje të mirë. Pranë shtëpisë kryesore gjendej një faltore familjare, të cilën nuk do t'i vinte keq ta vizitonte. Aty vuri re se çatia ishte e zbuluar në disa vende për shkak të tjegullave të rëna nga moti i keq dhe nga mosmirëmbajtja. Copat ishin e rëna ishin bërë grumbull poshtë dhe askush nuk kishte marrë mundimin t'i hiqte.

Dëgjoi ta thërrisnin dhe ktheu kokën.

Maja Salvo po i dilte përpara me një fustan lesi gri që i rrinte puthitur me ijët dhe i mbërrinte gati deri te gjunjë.

- Mirë se erdhët, zoti Xherber, - e përshëndeti duke i zgjatur dorën, me atë theksin e veçantë dhe të këndshëm mes finlandishtes dhe dialektit fiorentin. Dukej vërtet e gëzuar që po e shihte.

Edhe Xherberi ia shtrëngoi dorën duke vrarë mendjen nëse Maja e kishte vrarë mendjen se çfarë do të vishte për atë takim. Në çast, u pendua që e formuloi atë mendim.

- Këtu qenka shumë bukur, - komentoi, duke u rrotulluar për ta hequr vështrimin prej saj.

- Po, vetëm se gjynah që nuk merret kurrkush, - shtoi vajza me trishtim e më tregoi nga shtëpia. - Ejani, zonja Vanini do të na bëjë kafënë.

Kaluan nëpër një sërë sallonesh, duke ecur nëpër korridore me pllaka balte të vjetra. Mbi koka varehin tavane me afreske dhe zbukurime. Mobiliet antike ishin mbuluar me pëlhura të bardha. Llambadarët, kuadro, sixhadet e mureve dhe pasqyrat ishin mbuluar për t'u mbrojtur nga pluhuri. Të krijohej ideja sikur gjendeshe në një kuvend fantazmash.

- Shtëpia ka më shumë se pesëdhjetë dhoma, - i shpjegoi Maja. - Por siç ju kam thënë, ne rrimë vetëm në krahun e lindjes.

Në mjediset e mëdha e të heshtura, jehonte edhe tingulli më i vogël. Duke iu afruar kuzhinës Xherberi

- Jam vërtet e lumtur që Maja arriti t'ju mbushte mendjen, - tha zonja Vanini, duke e pritur Xherberin me dorën e zgjatur drejt tij.

Teksa po ia shtrëngonte, Pjetri e kuptoi se tringëllima që kishte dëgjuar pak më parë vinte nga byzylyku prej argjendi me rrathë të vegjël në formë iriqi.

Aty te të dyzet e pestat, me natyrën tipike të toskanëve dhe sjelljen e drejtpërdrejtë, ajo grua mund të quhej mjaft e pashme. Flokët e lidhur bisht, pak tualet te sytë, xhinse dhe atlete, krejt e kundërta nga sa njeriu mund të përfytyrojë një guvernante, tha Xherberi me vete. Adela, të cilën ata e kishin pasur te vila në Porto Erkole, ngjante më tepër me një hallë të moshuar, sado që në atë kohë nuk duhej të kishte qenë shumë më e madhe në moshë se zonja Vanini.

Pak më pas, guvernantja i shërbeu atij dhe Majës kafënë e sapodalë nga aparati.

- Më në fund dikush po merret me shëndetin mendoj të kësaj vogëlusheje, - komentoi ajo.

- Nuk e them dot me siguri nëse unë jam specialisti më i përshtatshëm për rastin e Evës, - saktësoi psikologu duke marrë filxhanin. Nuk donte të ngjallte entuziazëm pa u njohur me vajzën. Deri atëherë, më mirë të mos krijonte iluzione tek askush.

- Zonja Vanini e di mirë si janë punët, - ndërhyri Maja. - Ia kam shpjeguar unë, - shtoi duke e djegur me sy.

- Ah, zotëri, sikur ju mos ta pranoni Evën për paciente, do të ishte një mynxyrë e vërtetë, - i tha pa dashur t'ia dinte për qortimet e Majës. - Ajo është një engjëll që i duhet të përballlet me faktin që jeton e vulosur në këtë shtëpi që po bie copa-copa. Dhe të ëmës, e cila bredh nëpër botë e kushedi se ç'bën, i duket si ferrë nëpër këmbë.

- Të lutem tan... - u mundua ta ndërpriste Maja.

- Pse, çfarë ka? Ma lër ta them. - Gruaja ishte si një lumë i vërshuar. - A e dini prej sa kohësh kontesha Oneli Katelani nuk e shikon të bijën? - e pyeti me një ton përçmues. Xherberi nuk e dinte përgjigjen, por ishte i sigurt se edhe pak dhe do ta shihte me sytë e tij atë realitetin skandaloz.

- Gjashtë muaj, - tha në fakt Vanini duke treguar edhe me gishta. - Zonja nuk na erdhi as për Krishtlindje. - Lëvizte duart dhe krakëllima e byzylykut iriq ia theksonte fjalët.

- Të lutem... - ngulmoi Maja më kot.

- Unë kam një burrë dhe tre djem në shtëpi, dhe sado që ndonjëherë më vjen t'i le e të iki, nuk do të merrja kurrë guximin t'i braktisja, - vazhdoi tjetra pa iu dridhur syri. - Dhe tani, sikur të mos mjaftonte kjo, Eva duhet të mbajë mbi kurriz edhe tërë angaritë e atij shokut imagjinar.

Xherberi vuri re se ishte vërtet e zemëruar dhe e fyer. Njëllor si Maja, edhe ajo duhej ta donte shumë vajzën e vogël. Nga sa kishte kuptuar ai, zonja Vanini duhej të merrej me pastrimin dhe gatimin dhe çdo mbrëmje, pasi mbaronte punë shkonte në një fraksion të San Xhiminjanos ku banonte me familjen.

Guvernanta po vazhdonte me fantazitë e saj kur për një çast Pjetri pa te pragu i derës një kokë të vogël me flokë të verdha. Kjo zgjati fare pak, por ai bëri një lëvizje të kokës për nga dera e hapur e korridorit dhe vuri me shpejtësi një gisht te buzët për t'i bërë shenjë Vaninit se ndoshta ishte çasti të pushonte.

Kishte vrarë mendjen se nga duhej të kishte qenë vogëlushja për tërë kohën që ata bisedonin. Tani e dinte.

U ngrit duke lënë filxhanin bosh mbi tryezë dhe tha: - Tani duhet të më prezantoni me Evën.